



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; ww-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2018

V E N D I M

Nr. 214 , Datë 19/12/ 2018

PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUA NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE, TIRANË
për periudhën 01.09.2016 deri në 31.07.2018

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Tiranë, me objekt “Auditim përputhshmërie”, për periudhën 01.09.2016 deri në 31.07.2018 u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën japim opinion të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Tiranë me objekt “Auditim përputhshmërie”, për periudhën 01.09.2016 deri në 31.07.2018.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit “ISSAI 4000”; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga AKBN të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve,

mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që zbaton AKBN.

Përgjegjësit e audituesit janë:

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) dhe konkretisht ISSAI 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë*”, pjesë e raportit tonë (faqja 4). KLSH është e pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30, Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. KLSH i ka përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, ***por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.*** Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

Opinionin e auditimit:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin AKBN, u konstatuan devijime të rëndësishme materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilën ***japim opinion të kualifikuar.***¹

II. GJETJE NGA AUDITIMI DHE REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME LIGJORE

A. 1. Për shfrytëzimi i burimeve hidrokarbure (Marrëveshjet Hidrokarbure):

1. Gjetje nga auditimi. Gjatë zbatimit të Licencë Marrëveshje (LM) dhe Marrëveshja Hidrokarbure (MH) për shfrytëzimin e vendburimit të naftës Patos-Marinës nga kompania B..., u konstatua se kjo kompani, ka kryer disa shpenzime që nuk kanë të bëjnë dhe nuk lidhen me Operacionet Hidrokarbure, p.sh, rastin e borxhit të keq, që për arsye të pamundësisë për të arkëtuar detyrimin në vlerën 17,099,148 USD, si pasoje e ndërprerjes së kontratës së shitjes së naftës me nën kontraktorin e saj e ka konsideruar këtë vlerë të ardhurat e munguara dhe e ka pasqyruar si kosto hidrokarbure të rikuperueshme, apo si pasojë e ndërprerjes së kontratës me kompaninë BP, duke i paguar asaj shpenzime ligjore dhe gjyqësore vlerën 4,714,803 USD dhe duke e dëmshpërblyer në vlerën 16,500,050 USD. Këto raste apo edhe raste të tjera të konstatuara kanë ndodhur sepse në aneksin B “Kostot Hidrokarbure” të MH të B..., por edhe të MH të lidhura me kompanitë e tjera (marrëveshjet hidrokarbure janë TIP), disa zëra të operacioneve hidrokarbure nuk janë përcaktuar në mënyrë shteruese dhe lejojnë hapësira për interpretime të ndryshme, p.sh:

-Në pikën 7 “Shërbimet” të nenit 2, përcaktohet se, njihen si kosto hidrokarbure: “*Kostot aktuale të kontratës së shërbimit, konsulentët profesioniste, dhe shërbime të tjera të kryera nga palët e treta*”.

Fjalitë shërbime të tjera të kryera nga palët e treta, nuk është shteruese, por lejon hapësira që kompanitë kontraktore të konsiderojnë si shpenzime për operacione hidrokarbure, çfarë do lloj shërbimi, edhe përse ky apo ato shërbime mundë të mos kenë lidhje fare me operacionet hidrokarbure dhe nuk i shërbejnë atyre.

-Në pikën 9 të nenit 2 “Sigurimet dhe Pretendimet”, përcaktohet se, njihen si kosto hidrokarbure: “*Pagesat e bëra për sigurim për të mbuluar risqet në lidhje me Operacionet Hidrokarbure në*

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

përputhje me praktiken e Kontraktorit ose ndonjë prej punonjësve të tij dhe/ose i huaj, e cila është në përputhje me praktiken ndërkombëtare të industrisë së naftës ose që kërkohet me ligj. Në përputhje me Nenin 26.2 të Marrëveshjes, shpenzimet aktuale të kryera për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmtimeve, gjykimeve, dhe shpenzimet e tjera në dobi të Operacioneve Hidrokarbure”.

Fjalìa, shpenzimet e tjera, nuk është shteruese dhe lejon hapësira që kompanitë kontraktore të konsiderojnë si shpenzime për operacione hidrokarbure çfarë do lloj sigurimi dhe pretendimi edhe nëse ato mund të mos kenë fare lidhje me operacionet hidrokarbure

-Në pikën 13, të nenit 2 “Shpenzimet Ligjore” përcaktohet se, njihen si kosto hidrokarbure: “Të gjitha kosto ose shpenzimet e shërbimeve gjyqësore ose ligjore për të mbrojtur interesin e Kontraktorit në Zonën e Kontratës sipas ose në përputhje me Marrëveshjen dhe siç mund të nevojiten ose mjete duke përfshirë por pa u kufizuar në pagesat e konsultave ligjore, kostot e arbitrazhit, kostot e gjyqit, koston e investigimit ose prokurimit ndaj dëshmisë dhe sasitë e paguara në zgjidhjen ose përmbushjen e ndonjë gjykimi të tillë ose pretendimeve. Këto shërbime mund të kryhen nga stafi ligjor i Kontraktorit dhe/ose një firmë e huaj siç mund të jetë e nevojshme, me kusht që këto kosto nuk kanë rrjedhur nga konfliktet e pasuksesshme të Kontraktorit me Albpetrolin’.

Fjalìa, duke përfshirë por pa u kufizuar në pagesat e konsultave ligjore nuk është shteruese dhe lejon hapësira që kompanitë kontraktore të konsiderojnë si shpenzime për operacione hidrokarbure çfarë do lloj kosto ose shpenzime për shërbimet gjyqësore ose ligjore, pavarësisht se këto shërbime nuk mund të kenë lidhje me operacionet hidrokarbure (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqe 29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.Rekomandimi:

AKBN, MIE, Albpetrol në bashkëpunim me kompanitë që kanë të lidhura marrëveshje hidrokarbure të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, për të përmirësuar marrëveshjet hidrokarbure në lidhje me përcaktimin e saktë dhe në mënyrë shteruese të zërave të koston së operacioneve hidrokarbure.

Menjëherë

A.2. Për shfrytëzimi i burimeve minerare:

2. Gjetje nga auditimi. Sipas të dhënave që administrohen në dosjet e shfrytëzimit mineral në territorin e Shqipërisë janë dhënë leje me objekt “Shfrytëzim zhavorre bituminoze”, për të cilën nuk ka referencë për rentën e këtij minerali në shtojcën nr. 2, të ligjit nr. nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin që administrohet në dosjet e subjekteve dhe evidencat e rinovimit të lejeve të shfrytëzimit mineral konstatohet se, renta e paguar për shfrytëzimin e këtij mineralit nga disa subjekte është deklaruar dhe llogaritur me tarifa të ndryshme e konkretisht:

-Subjekti “S..” me lejë shfrytëzimi nr. 355, për vitin 2017 ka nxjerrë dhe shitur 19,181 ton zhavorr bituminoz, për këtë sasi renta është llogaritur me tarifën prej 289 lekë/ton;

-Subjekti “R...” me leje shfrytëzimi nr. 390 për vitin 2017 ka nxjerrë dhe shitur 4,768 ton zhavorr bituminoz, për këtë sasi renta minerare është llogaritur me tarifën 127 lekë/ton;

-Subjekti “T.....” me lejë shfrytëzimi nr. 1115, për vitin 2017 ka nxjerrë dhe shitur gjithsej 38,354 ton zhavorr bituminoz, renta është llogaritur me tarifën 186 lekë/ton;

-Subjekti “M...” me lejë shfrytëzimi nr. 1371, për vitin 2017 ka nxjerrë dhe shitur gjithsej 15,808 ton zhavorr bituminoz, renta është llogaritur me tarifën 186 lekë/ton.

Për sa më sipër, nisur nga shfrytëzimi me ekonomicitet dhe efektivitet i pasurisë publike me qëllim rritjen e të ardhurave buxhetore, renta minerare duhet të jetë e unifikuar dhe e barabartë për çdo subjekt që zotëron lejë shfrytëzimi dhe në kushtet e konkurrencës së lire midis subjekteve, renta duhet të llogaritet me tarifën 289 lekë/ton.

Llogaritja e rentës për sasinë e shitur prej 58,930 ton zhavorr bituminoz me tarifë të diferencuar dhe më të ulët se 289 lekë/ton, ka sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit **në shumën prej 6,070,000 lekë** {(58,930: (289-186)} (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqe 59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Rekomandimi:

AKBN, të marrë masa dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë për të kërkuar dhe përcaktuar nga Këshilli i Ministrave një tarifë të veçantë fikse për mineralin “Zhavorr bituminoz” në shtojcën nr. 2, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, pasi aktualisht nuk rezulton të ketë tarifë individuale ndonëse nxirret në sasi të konsiderueshme, me qëllim shmangien nga favorizimi që mund t'i bëhen subjekteve të veçanta nëpërmjet pagimit të diferencuar të rentës minerare.

Menjëherë

B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE

B. 1. Për, Licencë Marrëveshjen dhe Marrëveshjen Hidrokarbure me kompaninë “B.....” për vendburimin e naftës Patos-Marinëz:

1. Gjetje nga auditimi. MH me B.. përfshin zhvillimin dhe prodhimin e naftës në vendburimin Patos-Marinëz e cila zë rreth 95-98 të prodhimit ekzistues të naftës në rangë vendi. Data efektive e kësaj marrëveshje është 20.07.2004 dhe aktualisht ajo ndodhet në vitin e 14 të saj dhe do të zgjasë deri në 25 vjet. Fillimisht kjo marrëveshje është nënshkruar me kompaninë S... ndërsa në vitin 2005 interesat e kësaj marrëveshje u blenë nga kompania B... Në shtator 2016 aksionet e kompanisë B.. u blenë nga kompania kineze “G...” e cila vijon kryerjen e operacioneve hidrokarbure, duke ruajtur të njëjtin emër. Problem tepër shqetësues i kompanisë B... janë vonesat për miratimin e planeve dhe buxheteve vjetore që vet kompania propozon për tu realizuar gjatë një viti, të cilat janë bërë gjithmonë me shumë vonese. Kjo ka sjelle që ndonjëherë këto programe janë miratuar edhe formalisht. Kështu, për 2018 ky program u dorëzua pranë AKBN dhe u miratua në fund të muajit Mars 2018. Ky veprim e komprometon seriozisht realizimin e termave dhe operacioneve të parashikuara për tu kryer. Pasi e njëjta gjë ka ndodhur edhe për vitet e tjera, konkretisht, programi i vitit 2016 u miratua në nëntor 2017, programi i vitit 2015 u miratua në qershor të vitit 2016 dhe programi i vitit 2014 u miratua në shkurt 2015, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1. Rekomandimi:

Nga ana e AKBN, të mos tolerohen praktikat e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura. Të ndiqen me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në MH dhe LM për shqyrtimin dhe dakordësimin e Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi. Gjate periudhës 01.01.2008 deri më 30.06.2018, numri i puseve të shpuar ka shkuar në 664 puse. Vetëm gjatë periudhës së auditimit u shpuan 36 puse respektivisht: gjatë vitit 2016 u shpuan 8 puse, gjatë vitit 2017 u shpuan 16 dhe gjatë vitit 2018 u shpuan 12 puse. Në kuadër të kësaj marrëveshje, që nga fillimi e deri në momentin e auditimit (mars 2018), janë shpenzuar gjithsej rreth 3,027 milion USD. Për gjithë periudhën e MH, janë prodhuar gjithsej 8.74 milion ton naftë, nga e cila rreth 85% është shitur për eksport dhe vetëm 15% është shitur në tregun vendas, në një kohë që rafineritë e vendit kanë kapacitete të mjaftueshme për të përpunuar të gjithë këtë prodhim *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Rekomandimi:

MIE, AKBN dhe Albpetrol, duhet të bëjnë përpjekje dhe të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me B... që, nafta e prodhuar, fillimisht të shitet brenda vendit për plotësimin e kapaciteteve të rafinerive vendase dhe pjesa që mbetet të shkojë për eksport.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi. Shoqëria B... çdo vit parashikon në buxhetin e saj shpenzimet që do të kryejë në funksion të operacioneve hidrokarbure, shpenzime të cilat detajohen në zëra të ndryshëm në përputhje me shërbimet e parashikuara nga shoqëria B.... Në nenin 7 dhe në neni 8 të MH përcaktohet se, B.. *paraqet buxhetet vjetore të paktën 60 ditë përpara fillimit të vitit*

fiskal, dhe për zbatimin e buxheteve, sipas nenin 21.2 të kësaj Marrëveshje duhet të bëjë procedura prokurimi konkurruese për të gjitha kontratat që tejkalojnë vlerën vjetore prej 2,000,000 USD. Por, B... për të gjitha këto kontratat që kalojnë vlerën 2 milion USD, nuk ka vënë në dispozicion asnjë procedurë tenderuese. Referuar raporteve të auditimit të AKBN si dhe informacioneve të marra në AKBN rezultoi se, ashtu si në vitet e mëparshme dhe për këtë periudhë auditimi, B... nuk ka zhvilluar procedura konkurruese për kontratat që i tejkalojnë vlerën mbi 2 milion lekë. Konkretisht gjatë vitit 2016, 2017 ka lidhur kontratat për shërbime, punë dhe mallra me 15-17 kompani, ndërsa aktualisht në vitin 2018, ka të lidhura 7 kontrata me kompani të ndryshme të cilave kalojnë vlerën prej 2,000,000 USD të parashikuar në MH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 26-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.Rekomandimi:

AKBN ti kërkojë B.. që në përputhje me Nenin 21.2 të MH të zhvillojë procedura konkurruese për shërbime, punë dhe mallra që tejkalojnë vlerën vjetore mbi 2,000,000 USD.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi. Kompania B..., që para vitit 2016 ka pasur disa kontrata të lidhura për marrje me qira të tokave dhe shpenzimet e qirasë i ka pasqyruar si kosto hidrokarbure. Të gjitha këto kontrata ndodhen brenda zonës së kontratës dhe B.. edhe për vitet 2016,2017 dhe 2018 i ka në fuqi dhe në zbatim këto kontrata. Kështu, mbi bazën e këtyre kontratave, në vitin 2016, ka pasqyruar si kosto hidrokarbure qiratë e tokave vlerën prej 6,840,000 USD, në vitin 2017, ka pasqyruar si kosto hidrokarbure vlerën prej 6,393,000 USD dhe në periudhën janar-qershor 2018 ka pasqyruar si kosto hidrokarbure vlerën prej 3,350,000 USD.

Duke ju referuar raportit të auditimit për auditimin e kryer nga AKBN gjatë vitit 2017 për aktivitetin e B.. të vitin 2014 dhe me projektreportin për auditimin e kryer gjatë vitit 2018 për aktivitetin e B.. të vitin 2015, AKBN nuk ka njohur si kosto hidrokarbure vlerat e dala si pasojë e diferencës së çmimeve të qirasë së tokave që janë mbi vlerën e tregut lokal. Mos njohja e këtyre vlerave si kosto të parikuperueshme është mbështetur, bazuar dhe trajtuar në të njëjtin interpretim, arsyetim dhe logjikë si në rezultatet e auditimit të fundit të KLSH në të cilin është lënë rekomandim për mosnjohje si kosto hidrokarbure të rikuperueshme rreth 17,600,000 USD që ka të bëjë me diferencat e çmimeve të qirasë së tokave mbi çmimet e tregut. Në mungesë të dokumentacionit dhe në mbështetje të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit “ISSAI 1610” i cili lejon: *“Audituesin e jashtëm që të përdorë punën e auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose kohën, ose për të zvogëluar shkallën e procedurave të auditimit që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga audituesi i jashtëm”*, morëm në konsideratë të dhënat e raporteve të auditimit të kryera nga auditimi i brendshëm i AKBN, në lidhje me shpenzimet e qirasë së tokave dhe i trajtuam ato edhe për periudhën që është objekt i auditimit tonë ku rezultoi se, rritja e kostove hidrokarbure si pasojë e kontratave të lidhura për marrje me qirave të tokave bujqësore mbi çmimet e tregut lokal, për gjithë periudhën janar 2016 deri në qershor 2018 është në shumën e përgjithshme afërsisht 11,800,000 USD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 18-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi:

AKBN ti kërkojë, kompanisë B.. që para se të lidhë kontrata për marrje me qira të tokave dhe trojeve brenda zonës së kontratës, duhet të studioj tregun dhe të lidh kontratat me çmimet e qirasë së tregut dhe referencave ligjore në fuqi.

Në vijimësi

4.2. Rekomandimi:

Në rastet e marrjes së tokave me qira që janë në juridiksionin e Bashkisë Fier apo Bashkisë Ballsh, të kontraktohet direkt me këto njësi vendore dhe kontratat e qirasë të lidhen me çmimet e tregut lokal.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi. B..., që para vitit 2016, ka pasur disa kontrata të lidhura për marrje me qira të ambienteve të banimit dhe shpenzimet e qirasë i ka pasqyruar si kosto hidrokarbure. Këto kontrata edhe për vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë në fuqi dhe në zbatim. Duke ju referuar raportit të auditimit të kryer nga AKBN gjatë vitit 2017 për aktivitetin e B.. të vitin 2014 dhe të

vitit 2015, nuk i ka njohur si kosto hidrokarbure vlerat e dala si pasojë e diferencës së çmimeve të qerasë së banesave që janë mbi vlerën e tregut lokal. Ashtu si në rastet e qirave të tokave bujqësore (trajtuar më sipër, në pikën 4), mos njohja e këtyre vlerave si kosto të parikuperueshme është mbështetur, bazuar dhe është trajtuar në të njëjtin interpretim, arsyetim dhe logjikë si në rezultatet e auditimit të fundit të KLSH ku janë lënë rekomandime për mosnjohje si kosto hidrokarbure të rikuperueshmen rreth 3,700,000 USD që ka të bëjë me diferencat e çmimeve të qirasë së banesave mbi çmimet e tregut. Ndërsa për gjithë periudhën objekt auditimi (janar 2016 - qershor 2018), rezultoi se, kostot hidrokarbure janë rritur në shumën totale afërsisht rreth 1,590,000 USD si pasojë e çmimeve të kontratave mbi çmimet e tregut të qirasë së banesave dhe të referencave ligjore në fuqi, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 22-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.Rekomandimi:

AKBN ti kërkojë B.. që, në përputhje me Nenin 12.4 të MH, për përdorimin sa më eficient të shpenzimeve për projektin e Patos Marinzës të bëjë një vlerësim tregu lidhur me çmimet e qirave të banesave si dhe një analizë më afatgjatë të këtyre shpenzimeve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi. B.. gjatë periudhës objekt auditimi janar 2016 deri në qershor 2018 ka kryer disa shpenzime për operacione hidrokarbure, me çmimet mbi tregut vendas, mbi limitet dhe normativat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe ka kryer disa shpenzime të tjera që nuk kanë të bëjnë dhe nuk lidhen me Operacionet Hidrokarbure, duke rënduar padrejtësisht kostot hidrokarbure në vlerën totale rreth **88,700,000 USD**, e cila konsiderohet si kosto që nuk duhet të njihet dhe t'i rikuperohet. Rritja fiktive e kostove hidrokarbure ka sjellë efekte të ndjeshme në uljen e pjesës së fitimit të Alpetrolit dhe në uljen e fitimit të B.. dhe për pasojë në nivelin e tatimit mbi fitimin që duhet ti paguhet buxhetit të shtetit nëse arrihet faktori $R=1$. Mirëpo, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga B.. për vitin 2016, 2017 dhe 2018 (deri në qershor 2018) KLSH, nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto shpenzime në buxhetin e shtetit, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Rekomandimi:

Për të matrealizuar një auditim më të plotë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit publik, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", kërkojmë që, AKBN të bashkëpunoi me Albpetrolin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe në zbatim të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, të marrë zyrtarisht nga B..L të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar për vitin 2016, 2017 dhe periudhën janar – qershor 2018.

Deri më 31.03.2019

7. Gjetje nga auditimi. Gjatë viteve 2010-2016 pranë vendburimit të naftës Patos-Marinzë janë shfaqur fenomene të lëkundjes së tokës, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se e kanë burimin dhe janë të lidhura me operacionet hidrokarbure të kryera nga kompania B... Për këtë me Urdhrin e Kryeministrit nr. 178, datë 27.12.2016, u ngrit një grup pune për vlerësimin e situatës së krijuar nga lëkundjet e tokës në zonën e fshatit Zharrëz dhe për përcaktimin e masave që duhet të merren në varësi të shkaqeve të ndodhjes së fenomenit të lëkundjeve të tokës. Ky grup pune edhe pse ka dalë me rekomandime konkrete për MIE dhe Albpetrolin, ende nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare dhe aktualisht, MIE, Albpetrol dhe Avokatura e Shtetit, po ndjek këtë çështje nëpërmjet një ekspert i pavarur ndërkombëtar që do të vendos për shkaqet e këtyre lëkundjeve. Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara Drejtoria e Emergjencave Civile evidentoi se janë dëmtuar 508 shtëpi, nga të cilat me dëmtime shumë të rënda janë 26 banesa (të pa banueshme) dhe 44 banesa me dëmtime të rënda (kërkojnë ndërhyrje riparuese urgjente). Me VKM nr. 670, date 16.11.2017 është parashikuar që në fondin e përgjithshëm të ndihmës financiare prej 175,165,885 lekësh, një pjesë do të përballohet nga buxheti i shtetit, ndërsa pjesa

tjetër prej 101,173,814 leke do të përballohet nga B.. në formën e asistencës financiare për familjet e prekura nga lëkundjet e tokës. Kjo vlerë do të njihet dhe do të konsiderohet si kosto e rikuperueshme. Por, rezulton se në AKBN nuk ka informacion nëse kompania B.. ka shlyer dhe i ka likuiduar të gjithë familjet e prekura nga këto lëkundje, në zbatim të kësaj VKM, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 30-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7. Rekomandimi:

AKBN në bashkëpunim me MIE dhe Albpetrolin, të ndjekin problemet e lëkundjeve sizmike të vërejtura në vendburim që lidhen me teknologjinë aktuale të përdorur për nxjerrjen e naftës bruto nga ky vendburim, për të gjetur shkakun e vërtetë të këtyre lëkundjeve dhe nëse operacionet e kryera nga B.. lidhen me këto lëkundje, të marrin masa të menjëhershme për eliminimin e tyre, dhe në pa mundësi deri edhe në ndërprerjen e marrëveshjes hidrokarbure.

Menjëherë

B. 2. Për, Licencë Marrëveshjen dhe Marrëveshjen Hidrokarbure për vendburimin Ballsh-Hekal:

8. Gjetje nga auditimi. MH për vendburimin Ballsh-Hekal lidhur midis Albpetrol sha dhe kompanisë S....., është miratuar me VKM Nr. 509, date 08.08.20207. Data efektive e kësaj marrëveshje është data 24/08/2007 dhe aktualisht ajo është në vitin e 11 të implementimit të saj. Në Prill të vitit 2015, AKBN miratoi kalimin e interesave nga kompania S..... kompania T..... Kompania T..... ka vijuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure, mbështetur në programet e punës dhe buxhetet e miratuara për periudhën janar 2016 deri në maj 2018. Prodhimi i naftës gjatë periudhës ka qenë rreth 31% të prodhimit të parashikuar në planet e punës dhe buxhetet për gjithë periudhën 2007-2017. Ky mosrealizim është përgjithësisht pasojë e mos marrjes në dorëzim të pjesës tjetër të vendburimit në përputhje me parashikimin e Planit të Zhvillimit, por edhe për mungesë të investimeve dhe operacioneve që ndikojnë drejtpërdrejtë për rritjen e prodhimit të naftës. Kështu, që nga viti 2008 kompania vazhdon të operojë në 15 puse nga 22 puse që ka marrë në dorëzim, në një kohë që në gjithë vendburimin janë 81 puse aktive. Kompania ka insistuar shpesh për marrjen në dorëzim të pjesës tjetër të puseve, por Albpetrol nuk i ka dorëzuar këto puse edhe pse ato ndodhen brenda zonës së MH. Për pasojë, nga viti 2012 e në vazhdim, nuk reflektohet asnjë rritje të sasisë së nxjerrjes së naftës bruto nga vendburimi. Kjo sasi ka një rënie mjaft të madhe, në një trend prej gati 12% në vit. Ndërsa tek pjesa e pa dorëzuar e vendburimit, që aktualisht administrohet dhe shfrytëzohet nga Albpetrol sha, që nga viti 2013 e në vijim vërehet një rritje konstante e prodhimit me një trend prej gati 7.5% në vit (rritje nga 11,970 ton në muaj në vitin 2013 në rreth 19,500 ton në muaj, në vitin 2017). Pra, përforma e administrimit të vendburimit nga kompania Albpetrol është shumë më pozitive se ajo e kompanisë T.....

Nga kompania T., vërehen mungesa dhe vonesa të mëdha për kryerjen e investimeve kapitale, si dhe ka mbartur dhe vazhdon të këtë detyrime të pashlyera ndaj Albpetrolit në vlera të konsiderueshme monetare. Këto detyrime lidhen me mos pagesën e faturave për energjinë elektrike, detyrime për shërbime me agregate, detyrime për shërbime e prodhime mekanike, detyrime për shërbime gjeofizike dhe shërbime të tjera të remontit nëntokësor të ofruara nga Albpetrol. Nisur nga këto detyrime, Albpetrol sh.a, përdori instrumentin ekstra ligjor jashtë MH (me Përmbaues Ligjor) për të transferuar interesat dhe kalimin e të drejtave të MH nga shoqëria T.. tek shoqëria A....., si më poshtë:

Më date 02.10.2017 përmbauesi gjyqësor, z. Altin Vako, ka dërguar pranë AKBN-së Urdhrin e Ekzekutimit të Detyrueshëm për Kalimin e të drejtave të lindura nga shoqëria "T..", në favor të shoqërisë "A.....". Së bashku me këtë urdhrë është dërguar edhe dokumentacioni ligjor shoqëruar lidhur me procedurat përmbaimore të ndjekura nga zyra përmbaimore. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultoi se, janë marrë 9 Vendime Gjykatash, në kohë të ndryshme, për lëshimin e 9 Urdhrave të Ekzekutimit, për 7 subjekte të ndryshme, ku pjesën kryesore e zënë detyrimet në vlerën **94,245,125 lekë dhe 16,519.262 USD** që kjo kompani ka ndaj Albpetrolit. Bazuar mbi këto Urdhra e ekzekutimit, përmbauesi ka nxjerrë sekuestro konservative për të gjithë asetet e këtij vendburimi. Në datën 05.09.2017 ka marrë vendimin për përcaktimin e vlerës së

vendburimit dhe Eksperti i licencuar ka përcaktuar vlerën 1,251,139 USD. Në zbatim të nenit 555 të KPC, përmbaruesi vlerën e sendit, të vlerësuar nga eksperti e ka ulur në 20% duke e çuar në vlerën 100,911.2 USD. Më datën 13.09.2017 bën shpalljen “Për shitjen e sendit të luajtshëm në ankand”. Në datën e hapjes së ankandit 19.09.2017, sipas procesverbalit të ankandit nuk u paraqit asnjë ofertues. Pas përfundimit të Ankandit të parë, në referim të nenit 557 të KPC përcakton çmimin e ri të sendit në vlerën prej 700,637.84 USD. Në përfundim të ankandit të dytë, në datën 26.09.2017 është paraqitur vetëm shoqëria “ANIO OIL & GAS”, e cila është dhe fituese e ankandit me vlerë 700,637.84 USD. Dhe në datën 28.09.2017 përmbaruesi i drejtohet shoqërisë “Albpetrol” Sha, ku shpjegon hapat procedurale lidhur me ekzekutimin e Urdhrave të Ekzekutimit, njofton fituesin e ankandit dhe Urdhëron: “*Kalimin e të drejtave të lindura nga “MH për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin Ballsh-Hekal”, lidhur midis shoqërisë “Albpetrol” dhe shoqërisë “T..” në favor të shoqërisë “A....”*”.

Në lidhje me këtë transferim AKBN njofton me shkresë shoqërinë T..... Ndërsa Kompania T..... me shkresën Nr. 154/17, datë 16.10.2017 kundërshton veprimet përmbarimore si të pabazuara në ligj dhe njofton AKBN-në se shoqëria është duke vlerësuar këto veprime dhe se do të ndërmarrë të gjitha veprimet që i njuh ligji. Dhe me shkresën Nr. 159/17 datë 20.10.2017 ka njoftuar AKBN se, ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ankim për Kundërshtimin e Veprimeve Përmbarimore. ***Gjithashtu në këtë shkresë njofton se, i është drejtuar edhe studios ligjore që ndjek çështjen e arbitrazhit dhe vetë Gjykatës së Arbitrazhit për të shtuar në listën e çështjeve të arbitrazhit që e ka të hapur kundër Ministrisë, AKBN dhe Albpetrol sh.a, edhe veprimet përmbarimore të kryera nga përmbaruesi gjyqësor.*** Në lidhje me çështjen e arbitrazhit, AKBN nuk ka dijeni për pretendimet se, çfarë kërkon T....., por nga auditimi i progres raporteve të kostove hidrokarbure dhe planit të buxhetit të vitit 2017 që T....., dërgon në Albpetrol dhe AKBN, konstatoam se:

Albpetrol, në fund të vitit 2017 i detyrohet kompanisë T....., rreth 17,000 tonë naftë bruto, e cila e llogaritur më çmimin minimal që është rreth 250 USD toni, del një vlerë prej 4,250,000 USD. Ndërsa detyrimet që kompania T.. ka ndaj Albpetrolit, vetëm për Marrëveshjen e vendburimit të Ballsh-Hekalit, janë ***në vlerën 94,245,125 lekë dhe në vlerën 16,519.262 USD*** (sipas vendimeve të gjykatave të sipërcituara). Pra, detyrimi që i ka Albpetroli kompanisë T.., është pesë herë më i madh se, detyrimi që i ka, kompania T.., kompanisë Albpetrol. Në këto kushte, nga Albpetroli nuk ishte e nevojshme ti drejtohej gjykatave dhe përmbaruesit gjyqësor, por këto detyrime të ndërsjella mund të zgjidheshin me mirëkuptim dhe në rrugë administrative.

Po kështu, siç u trajtua më sipër një pretendim tjetër i kompanisë T.., ndoshta më kryesori është se, ***prodhimi i ulët i naftës rreth 31% në krahasim me parashikimin e planit të punës për gjithë periudhën 2007-2017 ka ardhur para se, të gjithash nga mos marrja në dorëzim të pjesës tjetër të vendburimit (të puseve aktive) të cilat do të ndikonin drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit të naftës, por siç u trajtua më lartë këto puse janë shfrytëzuar nga vet Albpetroli.***

Mjaftojnë vetëm këto dy fakte, përveç pretendimeve të tjera, që të dalësh në konkluzionin se kompania T.., nëse kërkon këto detyrime në Gjykatën e Arbitrazhit, buxheti i shtetit mund të ***pësojë humbje që mundë të shkojnë në vlera të konsiderueshme nga 30 milion USD deri në 50 milion USD*** (nga fitimi i munguar i prodhimit të naftës për puset e pa marra në dorëzim).

Në përfundim të këtij procesi, mbas shumë korrespondencash shkresore (midis AKBN, MIE, Albpetrolit, ASH, T.. “A.....”) që kanë zgjatur gati rreth 8 muaj, AKBN ka nënshkruar më datën 02.05.2018, Instrumentin e Transferimit, duke i dhënë ligjërisht shoqërisë “A....” të drejtat për të shfrytëzuar vendburimin Ballsh-Hekal, konform LM datë 04.07.2007 dhe MH datë 19.07.2007.

Sa sipër, AKBN ka dhënë miratimin e saj për “Kalimin e të drejtave në favor të shoqërisë “A...” vetëm në bazë të vlerësimit që i ka bërë Këshilli Teknik i Albpetrolit dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A...”, pa bërë vetë një analizë të thelluar të kapaciteteve tekniko financiare të shoqërisë “A...”, kërkesë kjo e përcaktuar qartë në:

- *Nenin 16 të MH, e cila e lejon transferimin e të drejtave dhe detyrimeve me kusht që Albpetrol të miratojë paraprakisht me shkrim këtë transferim. Në rast të kalimit të të drejtave, personi i cili i përfiton ato duhet të jetë teknikisht dhe financiarisht kompetent.*

-Nenin 22 të LM , e cila lejon transferimin e të drejtave dhe detyrimeve me kusht që AKBN të miratojë paraprakisht me shkrim këtë transferim. Në rast të kalimit të të drejtave, personi i cili i përfiton ato duhet të jetë teknikisht dhe financiarisht kompetent.

Nga shqyrtimi që auditimi i bëri dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A...”, në Këshillin Shkencor të Albpetrolit, në MIE dhe në AKBN rezultoi se, shoqëria kishte paraqitur, shumë pakë dokumente dhe mbështetur vetëm në to, nuk mund të sigurohet një panoramë e qartë, sepse këto dokumente nuk të japin siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme që, shoqëria “A...” i përmbush kapacitetet teknike e financiare dhe mundë të kryhej me sukses operacione hidrokarbure në përputhje me MH dhe LM.

Si përfundim, përmbaruesi gjyqësor në bashkëpunim me Albpetrol dhe me kreditorët e tjerë, kishin shteruar të gjitha procedurat administrative e ligjore për shlyerjen e detyrimeve nga shoqëria “T..”. Më pas shteruan të gjithë procedurën ligjore për realizimit e ankandit dhe e konkretizuan atë me lidhjen e kontratës me fituesin, shoqërinë “A...”, si dhe hartuan dhe lidhën marrëveshjen për kalimin e interesave të MH tek kjo shoqëri. Përfundimisht, MIE dhe AKBN ndodhur para këtij fakti edhe pse kanë insistuar, në pa mundësi për të gjetur hapësira ligjore për kundërshtimin e këtij transferimi, kanë miratuar marrëveshjen për kalimin e interesave tek shoqëria “A...”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 31-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi:

AKBN në bashkëpunim me MIE dhe Albpetrolin, të ngrenë një grup pune të përbashkët për të analizuar të gjitha detyrimet e ndërsjellat që kanë rrjedhur nga zbatimi i Marrëveshje Hidrokarbure ndërmjet Kompanisë “T..” dhe Albpetrolit për Vendburimin Ballsh-Hekal.

Menjëherë

8.2.Rekomandimi:

AKBN ti kërkojë Albpetrolit dhe Përmbaruesit Gjyqësor, që të paraqesin, dokumentacionin në lidhje me arkëtimin e vlerës 700,637.84 USD nga shoqëria fituese e ankandit “A...” si dhe dokumentacionin për shlyerjen e detyrimeve nga përmbaruesi, për të gjithë kreditorët e Vendburimit Ballsh-Hekal, për të cilët janë nxjerrë Urdhrat e Ekzekutimit të Gjykatave, e në veçanti shlyerjen e detyrimeve ndaj Albpetrolit i cili është edhe kreditori më i madh.

Menjëherë

8.3.Rekomandimi:

AKBN, MIE, Albpetrol dhe Avokati i Shtetit, të përgatiten për mbrojtjen ligjore dhe të bashkëpunojnë për të grumbulluar dokumente, fakte dhe prova, për ti paraqitur në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për të vërtetuar ligjshmërinë e kalimin e të drejtave të lindura nga “MH për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin Ballsh-Hekal”, datë 19.07.2007 lidhur midis shoqërisë “Albpetrol” Sha dhe shoqërisë “T..” në favor të shoqërisë “A...” sh.a.

Në vijimësi

B. 3. Për, Licencë Marrëveshjen dhe Marrëveshjen Hidrokarbure për vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul.

9. Gjetje nga auditimi. MH për vendburimet Cakran-Mollaj është lidhur midis kompanisë Albpetrol dhe S... Data efektive e kësaj marrëveshje ka qenë data 24.08.2007. Kjo marrëveshje ka qenë efektive deri në shkurt të vitit 2017, (gati 10 vjet), pasi kompania Albpetrol e ndërpreu në mënyre të njëanshme këtë marrëveshje, si më poshtë:

Shqetësues për këtë marrëveshje ka qenë rënia e prodhimit të naftës, e cila është pasoj e mungesës së investimeve që lidhen direkt me prodhimin e naftës. Kështu, nga 41 mijë ton nafte që është prodhuar gjate vitit 2012, prodhimi ka rënë në 16 mijë ton naftë në vitin 2016. Në muajin prill 2015, u miratua kalimi i interesave të kompanisë S..., tek kompania T... Edhe me marrjen në dorëzim të interesave nga kjo kompani, gjendja e kësaj marrëveshjeje nuk u përmirësua. Investimet nuk nisën të kryheshin dhe situata e përgjithshme nuk u përmirësua. Prodhimi vazhdoi me rënie dhe kompania vazhdoi të akumulojë detyrime të pa shlyera ndaj

Albpetrolit për mos dorëzim në kohë të sasive të naftës për PEP dhe ASP. Këto detyrime kapin një sasi prej rreth 5,000 ton naftë bruto, por edhe detyrime të tjera monetare. Nisur nga këto problematika, në shkurt të vitit 2017, kompania Albpetrol, ndryshe nga procedura e ndjekur për vendburimin e Ballsh-Hekal, ka bërë mbyllje në mënyrë të njëanshme të marrëveshjes për këtë vendburim, dhe që nga shkurti i vitit 2017, ky vendburim administrohet nga vetë kompania Albpetrol, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10. Gjetje nga auditimi. ML dhe MH për vendburimin Gorisht-Kocul, është lidhur midis kompanisë Albpetrol dhe S... Data efektive e kësaj marrëveshje është data 24.08.2007. Edhe kjo marrëveshje ka qenë efektive deri në shkurt të vitit 2017, sepse:

Edhe për këtë marrëveshje, shqetësues ka qenë rënia e prodhimit të naftës, e cila është rezultat i mungesës së investimeve që lidhen direkt me prodhimin e naftës. Nga rreth 45.4 mijë ton naftë që është prodhuar gjatë vitit 2014, prodhimi ka rënë në 29.8 mijë ton në vitin 2016. Edhe për këtë marrëveshje, në muajin prill 2015, u miratua kalimi i interesave të kompanisë S... tek kompania T... Por edhe pas marrjes në dorëzim të interesave nga T..., përsëri gjendja e kësaj marrëveshje nuk u përmirësua. Fakt është që investimet nuk nisen të kryeshin dhe situata e përgjithshme nuk u përmirësua. Prodhimi vazhdoi ende me rënie. T... vazhdoi të akumulonte detyrime të tjera të pa shlyera ndaj Albpetrolit për mos dorëzim në kohë të sasive të PEP dhe ASP. Këto detyrime kapin një sasi prej rreth 25.4 mijë ton naftë bruto, por edhe detyrime të tjera monetare. Detyrimet monetare për të dy marrëveshjet, për vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj, që i ka kompania T..., ***Albpetrolit llogariten rreth 15 milion USD.***

Si pasojë e këtyre problematikave, në shkurt të vitit 2017, kompania Albpetrol, përsëri ndryshe nga procedura e ndjekur për vendburimin e Ballsh-Hekal, ka bërë mbyllje në mënyrë të njëanshme dhe të kësaj marrëveshjeje.

Për mbylljen nga Albpetrol të të dy marrëveshjeve, kompania T..., ka bërë ankim ndaj Albpetrolit, në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Për ndjekjen e këtij procesi dhe gjykimin në Arbitrazhin Ndërkombëtar, MIE dhe Albpetrol, kanë angazhuar Avokatin e Shtetit. Aktualisht, çështja është në proces e sipër (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 45-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9. Rekomandimi (për pikat 9 dhe 10) :

AKBN, MIE, Albpetrol dhe Avokati i Shtetit, në përputhje me Marrëveshjet Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjet, të përgatiten për mbrojtjen ligjore dhe të bashkëpunojnë për të grumbulluar dokumente, fakte dhe prova ligjore dhe ti paraqesin në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për të vërtetuar ligjshmërinë e mbylljes së njëanshme nga Albpetrolit të këtyre dy marrëveshjeve, me qëllim shmangien e pasojave të konsiderueshme që mundë ti vijnë buxhetit të shtetit, në rast humbjeje të kësaj çështjeje.

Në vijimësi

B.4. Për shfrytëzimin e burimeve minerare:

11. Gjetje nga auditimi. Në nenin 2, të ligjit 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, pika 24, "Përkufizime" është përcaktuar se: "*Monitorim minerar dhe post minerar" është vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare*". Në zbatim të këtij detyrimi, nga inspektimet e kryera pranë çdo subjekti sipas programeve të kontrollit, Drejtoria Minerare ka mbajtur akt konstatimi për veprimtarinë e shfrytëzimit minerar, por ky formular nuk përmban të dhëna për matjet fizike të kryera mbi volumet e punës së kryer në fakt, për t'u bërë pjesë e dosjes së monitorimit me qëllim krahasimin e volumeve të shfrytëzimit të deklaruar nga çdo subjekt me rezultatin e nxjerrë nga matjet fizike nga kjo drejtori. Ky rakordim, do shërbejë jo vetëm për ushtrimin e kontrollit në funksion të ligjit të mësipërm, por duhet të jetë dokument bazë për

verifikimin e saktësisë së deklarimeve të shoqërive minerare për volumin e punës së kryer në fakt, të ardhurat e realizuara nga shitja dhe renta minerare e deklaruar dhe e paguar në buxhetin e shtetit.

Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatim Taksave ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, ka sjellë si pasojë që prodhimi i mineralit të nxjerrë dhe të shitur dhe renta minerare të deklarohen dhe të pranohet në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal ndaj të ardhurave tatimore dhe buxhetit të shtetit, pasi edhe ato matje që mund të jenë kryer nuk janë vënë në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të nenit 1 dhe 2 të pikës 24 të, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 56-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10. Rekomandimi:

AKBN, në zbatim të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave” dhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, nëpërmjet grupeve të kontaktit të marrë masa për:

-Shkëmbimin e informacionit në kohë reale, për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerare, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare, që nëpërmjet kontrollit teknik, ekonomik dhe fiskal të kryqëzojnë volumet e deklaruara nga subjektet pranë Degëve të Tatim Taksave apo në Dogana me volumin dhe stokun e prodhimit të matur fizikisht nga AKBN, si një faktor i rëndësishëm jo vetëm për realizimin e qëllimit të marrëveshjes së bashkëpunim por edhe mbrojtjen e pronës publike nga shfrytëzimi i pa dokumentuar, me qëllim kufizimin në maksimum të evazionit fiskal duke ndikuar efektivisht në rritjen e të ardhurave buxhetore dhe të mirëqenies së popullsisë si një prioritet i Strategjisë Minerare në Republikën e Shqipërisë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi. Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, por në dosjet e monitorimit në asnjë rast nuk e gjend dhe nuk u provua nëse ka funksionuar ky bashkëpunim. Për këtë AKBN ka dërguar dy shkresa respektivisht nr. 1920 dhe 1922, datë 12.02.2016 respektivisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave për të marrë informacion nga këto institucione për prodhimin e shitur brenda vendit dhe të eksportuar, por kjo marrëveshje ka mbetur e pa finalizuar, pasi edhe në rast se konstatohen diferenca në prodhimin e shitur, të ardhurat e realizuara dhe diferenca në llogaritjen e detyrimeve ndaj buxhetit për rentën e padeklaruar (apo të fshehur) AKBN nuk mund t’i arkëtojë këto detyrime. Në zbatim të marrëveshjes dypalëshe, shkëmbimi i informacionit nuk është bërë nga secila palë konform pikës 1 dhe 2, të nenit 2 të kësaj marrëveshje, pasi nuk u gjend asnjë komunikim midis palëve që kanë nënshkruar marrëveshjen për të realizuar kryqëzimin e treguesve të prodhimit nga personat e kontaktit dhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në rrugë elektronike, siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj marrëveshje (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 57-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.Rekomandimi:

AKBN në zbatim të marrëveshjes dypalëshe të lidhura, me Drejtorinë e Tatimeve dhe Doganave respektivisht me nr. 1920 dhe 1922, datë 12.02.2016, të marrë masa për të shkëmbyer informacione periodike dhe në kohe reale për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerale, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore.

-Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do bëhet e mundur kontrolli teknik, ekonomik dhe fiskal duke kryqëzuar volumet e deklaruara nga vetë subjektet me volumin dhe stokun e prodhimit të matur

fizikisht nga AKBN, si një faktor i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi. Në dosjet e monitorimit në pjesën më të madhe të subjekteve që zotërojnë shfrytëzimi minerar nuk u gjenden fatura tatimore për sasinë e prodhimit të shitur dhe çmimet për njësi, deklarata mujore për shitjet, apo përmbledhëse e librit të shitjeve të deklaruara në Degën e Tatim Taksave, me qëllim administrimin e dokumenteve në dosjen e monitorimit që lidhen me të ardhurat e realizuara nga shitja dhe pagimin e rentës minerare, konform ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 dhe VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)”, e cila në ushtrimin e veprimtarisë së saj, krahas detyrave teknike kërkon edhe *“respektimin e pagesave të detyrimeve ndaj shtetit konkretisht të tatim taksave”, e cila është edhe një prej kushteve për rinovimin e lejes së shfrytëzimit për periudhën pasardhëse, (Më hollësisht trajtuar në pikë 4, në faqet 59-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa që në miratimin e raportit të aktivitetit të vitit ushtrimor të kërkojë nga subjektet që zotërojnë leje minerare që krahas deklarimit të aktivitetit ekonomiko-financiar të argumentojnë veprimtarinë tregtare me dokumentacion justifikues si faturat e shitjes së prodhimit, çmimin e shitjes dhe rentën e llogaritur dhe të konfirmuar nga degët e tatim taksave ku kanë selinë

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi. Nga verifikimi i dokumentacionit që administrohet në dosjet e subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar, konstatohet se një numër i konsiderueshëm i shoqërive që zotërojnë leje minerare nuk llogarisin koston e prodhimit, sipas strukturës dhe zërave të shpenzimeve dhe çmimin e shitjes së prodhimit si tregues i rëndësishëm jo vetëm për bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve, por edhe për garantimin e suksesshëm dhe efektiv të rentabilitetit financiar për vazhdimësinë e punës për shfrytëzimin e mineralit në periudhat e ardhshme në interes të komunitetit dhe të të ardhurave buxhetore, si dhe rigjenerimin e mjedisit për rreth zonës së shfrytëzimit si një kusht i rëndësishëm mjedisor i përcaktuar në lejet e shfrytëzimit, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa që, për çdo program pune me objekt shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga zotëruesit e lejeve minerare dhe informacionin vjetor për veprimtarinë e realizuar, monitorimin e aktivitetit të subjekteve që kryejnë shfrytëzimin të mineraleve ndërtimore jo metalore dhe metalore, detyrimisht të kërkojë nga çdo subjekt që në miratimin e aktivitetit vjetor të ketë paraqitur edhe strukturën e kostos faktike, e sidomos përcaktimin e saktë të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore dhe rentën e deklaruar dhe të paguar në fakt me qëllim minimizimin e evazionin fiskal për të ardhurat buxhetore.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi respektimin e llogaritjes së rentës minerare të deklaruar nga shoqëritë që zotërojnë leje shfrytëzimi të mineraleve, u konstatua se peshën specifike më të madhe në realizimin e rentës minerare e kanë subjektet që shfrytëzojnë dhe prodhojnë mineralin “Gurë gëlqerorë” për prodhim çimento, në zonën e Krujës, kështu, dy prej subjekteve që zotërojnë licence për prodhim çimento për vitin 2017 kanë prodhuar gjithsej 2,522,914 ton gurë gëlqerorë, respektivisht shoqëria “F...” në sasinë prej 1,205,564 ton dhe shoqëria “A...” sasinë prej 1,317,350 ton. Këto subjekte kanë llogaritur rentën mbi bazën e prodhimit dhe jo mbi bazën e mineralit të nxjerrë dhe të kontabilizuar për prodhimin e çimentos. Renta për çdo subjekt është llogaritur si më poshtë:

a. Për shoqërinë “F...” renta është llogaritur në vlerën prej 32,194.756 lekë ose me tarifën mesatare prej 26.7 lekë/ton dhe jo me tarifën prej 47 lekë/ton të përcaktuar në shtojcën nr. 2, të ligjit 9975, date 28.07.2008, duke sjellë si pasojë evazion fiskal në shumën prej 24,566,752 lekë,

b.Për shoqërinë “A...” renta është llogaritur në shumën prej 46,078,492 lekë ose me tarifën mesatare prej 34.9 lekë/ton dhe jo me tarifën prej 47 lekë/ton të përcaktuar në shtojcën nr. 2, të ligjit 9975, date 28.07.2008, duke sjellë si pasojë evazion fiskal në shumën prej 15,836,958 lekë. Dy subjektet e mësipërme nuk kanë deklaruar dhe llogaritur rentën sipas tarifës së përcaktuar në ligjin “Për taksat Kombëtare” duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat buxhetore në shumën prej 40,403,710 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73,të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14. Rekomandimi:

AKBN në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave të përcaktojnë rregulla dhe veprime kontabël në mënyrë që prodhimi i nxjerrë nga shoqëritë e licencuara për prodhim çimento të konrabilizohet edhe si prodhim i shitur me qëllim llogaritjen dhe deklarimin e rentës minerare konform ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 dhe VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të subjekteve që kanë paraqitur programin e aktivitetit ekonomik-financiar për periudhën e monitoruar dhe të administruar në dosjet e monitorimeve u konstatuan mangësi ndër të cilat përmendim:

Pasqyra e treguesve të realizimit ekonomik financiar nuk është plotësuar sipas modelit që kërkon AKBN, pasi:

-Nuk ka të dhëna për sasinë apo volumin e prodhimit të nxjerrë (ton ose m³) në kundërshtim me nenin 36, pika 11 e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare”, ku përcaktohet se:

“Të realizojë dhe të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor”.

-Nuk ka të dhëna për sasinë e prodhimit të shitur, koston e prodhimit

-Prodhimi i shitur nuk është justifikuar me fatura tatimore të shitjes së produktit të gatshëm, me qëllim dokumentimin dhe evidentimin e rentës së paguar në fakt siç përcaktohet në 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73,të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa që, për çdo program pune me objekt shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga zotëruesit e lejeve minerare dhe informacionin vjetor për veprimtarinë e realizuar, monitorimin e aktivitetit të subjekteve që kryejnë shfrytëzimin të mineraleve ndërtimore jo metalore dhe metalore, të kërkojë nga çdo subjekt që në miratimin e aktivitetit vjetor të paraqesë të dhëna dokumentare për prodhimin e nxjerrë, prodhimin e shitur të shoqëruar me fatura të modelit tatimor, të ardhurat shpenzimet dhe strukturën e koston faktike.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e shfrytëzimit minerar dhe në evidencat e realizimit të prodhimit vjetor të deklaruar nga shoqëritë e licencuara për shfrytëzim të pasurive minerare metalore dhe jo metalore, konstatohet se për vitin 2016 dhe 2017, një numër i konsiderueshëm i subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar dhe jo minerar, kanë deklaruar mbylljen e aktivitetit vjetor, por në dokumentacionin e depozituar në AKBN, nuk kanë deklaruar prodhim, apo gjendje produkti të nxjerrë nga periudhat e mëparshme. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme që këto subjekte të shfrytëzojnë pa kriter dhe në mënyrë të jashtë ligjshme pasurinë kombëtare. Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin që administrohet në dosjen e këtyre subjekteve nuk u gjend asnjë raport monitorimi nga Drejtoria Minerare për të verifikuar në se këto subjekte ushtrojnë aktivitet të fshehur, nxjerrin prodhim dhe krijojnë të ardhura, të jashtëligjshme duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat buxhetore, mospagim të sigurimeve shoqërore për të punësuarit dhe rentë

minerare për shfrytëzim të burimeve natyrore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për të ushtruar kontroll me qëllim verifikimin e gjendjes reale për të gjitha shoqëritë që kanë deklaruar mbylljen e aktivitetit, për të verifikuar nëse aktiviteti i deklaruar vazhdon të jetë i mbyllur apo kryen aktivitet të paligjshëm me pasojë evazion fiskal për të ardhurat buxhetore.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i kryer në dosjet e subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar u konstatua se një numër i konsiderueshëm i subjekteve nuk kanë paraqitur formularin Esig-25, si një formular i detyrueshëm për rinovimin e lejes së shfrytëzimit dhe monitorimit, veprim i cili është në kundërshtim me VKM nr. 1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, kërkesë që ka të bëjë jo vetëm me sigurimin e jetës së çdo punonjësi nga aksidentet në punë por edhe me evidentimin e punonjësve për të shmangur “punësimin në të zezë”, e cila është detyrimin ligjor, jo vetëm për pagesën e sigurimeve shoqërore për punëtorët e regjistruar por edhe për pagesën e detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale.

Mungesa e këtij formulari është në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe 134/2014, neni 36, pika 3, ku përcaktohet:

“Shoqëria shfrytëzimit minerar të marrë masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punonjësve e të personave të tjerë, të cilët hyjnë në zonën e lejes minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e teknikës së sigurimit e të mbrojtjes në punë, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa që, për çdo program pune me objekt shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga zotëruesit e lejeve minerare dhe informacionin vjetor për veprimtarinë e realizuar, monitorimin e aktivitetit të subjekteve që kryejnë shfrytëzimin të mineraleve ndërtimore jo metalore dhe metalore, të kërkojë nga çdo subjekt që në miratimin e aktivitetit vjetor të paraqesë të dhëna të sakta për numrin e fuqisë punëtore të regjistruar dhe të shoqëruar me formularin “E-sig 25” për pagat e punonjësve dhe sigurime shoqërore të paguara si një ndër treguesit e rëndësishëm që lufton evazionin fiskal për të ardhurat e sigurimeve shoqërore.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi. “Tabela format” me të dhënat e paraqitura nga shoqëritë që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar të paraqitur për deklarimin e aktivitetit të vitit ushtrimor nuk plotësohet me të gjithë ekstremitetet e miratuara, si dhe nënshkruhet nga përgjegjësi i zyrës së statistikës, fakt që tregon se, ky dokument administrohet formalisht në dosjen e monitorimit, ndonëse konsiderohet si një formular i rëndësishëm statistikor që shërben për pasqyrimin real dhe cilësor të treguesve të prodhimit minerar dhe treguesve ekonomiko-financiar të shoqërisë dhe është dokument bazë për llogaritjen e prodhimit të brendshëm bruto (GDP) si dhe është kusht për rinovimin e lejes së shfrytëzimit në vitin pasardhës, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18. Rekomandimi:

Sektori i Statistikës të marrë masa dhe të kërkojë nga të gjitha shoqëritë që deklarojnë të dhëna statistikore për miratimin e programit vjetor të punës dhe rinovimin e lejes së shfrytëzimit, që formati tip i evidencës të plotësohet me të gjithë të dhënat e kërkuara, nëpërmjet të cilave të vlerësohet performanca e aktivitetit ekonomiko-financiar e çdo shoqërie që zotëron leje shfrytëzimi mineral.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i kryer në disa dosje të subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar konstatohet se, një numër i konsiderueshëm i shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar ndonëse realizojnë sasi të konsiderueshme prodhimi kanë nga 2 deri 3 punonjës, madje duhet theksuar se, në dy raste u konstatuan shoqëri që kanë deklaruar vetëm 1

punëtor të regjistruar me të cilin është e pamundur të realizohen proceset e punës si nxjerrje, përpunim, ngarkim dhe transport minerali sado i mekanizuar që të jenë proceset e punës, kështu përmendim:

-Shoqëria T.. ka të punësuar 1 punonjës me të cilin ka realizuar 524 m³ gurë masiv gëlqeror;

-Shoqëria "V..." shpk ka të punësuar 1 punonjës me të cilin ka realizuar 822 m³ gurë masiv gëlqeror.

Kjo mënyrë deklarimi tregon për deklarime te pasakta të numrit të fuqisë punëtore nga këto shoqëri, jo vetëm që sjell të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit nëpërmjet mos arkëtimit të detyrimeve për sigurime shoqërore por edhe stimulim mbajtje në punë të punonjësve të padeklaruar, me qëllim rritjen e të ardhurave në mënyrë të jashtëligjshme, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa për të ushtruar kontroll të befasishtëm, jo vetëm në dy shoqëritë e mësipërme për edhe kontrole rutinë në subjekte të tjera për verifikimin e numrit real të punëtorëve të aktivizuar, të regjistruar, me qëllim sigurimin e jetës së punonjësve dhe deklarimin e sigurimeve shoqërore në formularin E sig 25.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi. Nga të dhënat që administrohen në dosjet e monitorimit dhe në raportin vjetor të AKBN, konstatohet se një numër i konsiderueshëm i subjekteve të licencuar në zonën Berat-Skrapar nuk punojnë në sipërfaqet e tyre të licencuara, por kanë zhvendosur aktivitetin e tyre mineral në një sipërfaqe tjetër e cila është shpallur "Zonën e Mbrojtjes së Veçantë", në kundërshtim me Vendimin nr. 2, datë 21.11.2010 të Këshillit Kombëtar të Ujit. Brenda kësaj zone ushtrojnë aktivitet dhe subjekte e individë të pa licencuar që stimulohen nga subjekte të licencuar nëpërmjet blerjes së pllakave të gurit. Ka shume subjekte që nuk kanë leje minerare por kanë aktivitet në përpunimin e tyre duke ushtruar në këtë mënyrë veprimtari kontrabandë. AKBN megjithëse në çdo raport gjashtëmuor dhe vjetor ka kryer informime të vazhdueshme në "Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Minerave" pranë MIE dhe në Policinë e shtetit, por ato vazhdojnë aktivitetin e paligjshëm prej disa vitesh duke dëmtuar jo vetëm pasurinë kombëtare por edhe florën dhe faunën e kësaj zone..

Aktiviteti mineral në zona të mbrojtura dhe i pa licencuar nga MEI dhe QKB, përveçse është aktivitet ilegal, krijon dhe sipërfaqe të dëmtuara për të cilat nuk mund të përcaktohet asnjë subjekt përgjegjës për të kryer rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar.

Ky aktivitet stimulohet edhe nga subjekte që nuk kanë leje minerare shfrytëzimi por punojnë legalisht dhe konkurrojnë në mënyrë të jashtëligjshme subjektet e licencuara që paguajnë rregullisht detyrime tatimore, duke sjellë si pasojë evazion të konsiderueshëm për të ardhurat buxhetore, si për rentën minerare ashtu edhe nga garancia e rehabilitimit të mjedisit.

Për periudhën gjashtëmuore të vitit 2018 në Bashkinë Skrapar dhe kryesisht në objektin N... lejet e shfrytëzimit të grurit gëlqeror pllakor janë me bllokuar me "urdhër bllokimi" nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe shumë subjekte në këtë zonë nuk kanë zhvilluar aktivitet mineral, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20. Rekomandimi:

Drejtoria Minerare të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për të ushtruar kontroll me qëllim verifikimin e gjendjes reale në të gjithë zonat e mbrojtura me Vendimin nr. 2, datë 21.11.2010 të Këshillit Kombëtar të Ujit me qëllim evidentimin dhe bllokimin e aktivitetit të shoqërive që ushtrojnë aktivitet kontrabandë, të pa licencuar apo që kanë deklaruar dhe mbyllur aktivitetin.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi. Me vendimin e KM nr. 479, datë 29.06.2011 është miratuar "Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë", për mineralin e Bakrit është parashikuar që kompanitë minerare të orientohen drejt përdorimit të teknologjive moderne dhe eksploruese si dhe drejt studimeve komplekse që do të shërbejnë si bazë e nevojshme të dhënash për të ulur humbjet e mineralit të nxjerrë nëpërmjet teknologjive të reja, rritjen e rendimentit të prodhimit të

mineralit e rrjedhimisht uljen e kostos, rikuperim në pasurim 90-92%; aplikimi i një skeme përpunimi dhe pasurimi që të ketë parasysh marrjen e të gjitha elementeve shoqëruese (Au, Ag, Zn etj.) me efikasitet të lartë e veçanërisht për vendburimin e Munellës. Për këtë vendburim dhe të tjera vendburime të kërkohej mbyllja e plotë e ciklit të përpunimit të bakrit në vend, duke përfshirë të gjitha mineralet e zbuluara dhe nga kompani të tjera në zonë.

Sipas të dhënave të monitorimit konstatohet se, jo vetëm nuk është realizuar objektivi afatmesëm por kompanitë koncensionare në fabrikën e pasurimit realizojnë vetëm përpunimin e mineralit me qëllim rritjen e përqindjes së bakrit për njësinë e matjes në ton, duke mos kryer asnjë investim në drejtim të përpunimit të thellë të mineralit, me objektivi prodhimin e arit, argjendit zinkut, dhe elementëve të tjerë përbërës të këtij xeherori që për nga rëndësia konsiderohet pasuri e madhe kombëtare, që nuk ndikon aspak në rritjen e mirëqenies së popullsisë si një prioritet i Strategjisë minerare në Republikën e Shqipërisë, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21. Rekomandimi:

AKBN të nxisë dhe të inkurajojë shoqëritë koncensionare në mënyrë që të marrin masa në drejtim të përmbushjes së objektivi afatmesëm në përpunimin e mineralit për të kryer investime për përpunim të thellë të mineralit, me objektivi prodhimin e arit, argjendit, zinkut dhe elementëve të tjerë përbërës të këtij xeherori që për nga rëndësia konsiderohet pasuri e madhe kombëtare, me qëllim rritjen e të ardhurave buxhetore si një ndër prioritetet e strategjisë minerare në Republikën e Shqipërisë.

Në vijimësi

B.5. Për administrimin, vlerave materiale e monetare:

23. Gjetje nga auditimi. Për periudhën objekt auditimi Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka programuar dhe ka likuiduar shpenzime për studion ligjore “C...” të kontraktuar nga shoqëria “Albetrol”, për mbrojtjen e shtetit shqiptar nga padia e shoqërisë “B..” e cila kërkon dëmshpërblim në shumën prej 600 milion USD. Për periudhën objekt auditimi AKBN ka likuiduar studion ligjore në vlerën prej 331,597 mijë lekë ose rreth 3,000,000 USD. Nga auditimi mbi ligjshmërinë e këtij shpenzimi, konstatohet se pagesa e kryer ndonëse është justifikuar me kontratën e lidhur midis palëve, por shpenzimet janë llogaritur me orë pune pa përcaktuar vlerën totale në kontratë, fakt që tregon për mungesë transparence për këtë pagese apo edhe për pagesat që do të kryhen në periudhat e ardhshme. Gjithashtu duhet theksuar se nuk ka asnjë informacion se si do bëhet monitorimi për zbatimin e kushteve të kontratës deri në përfundim të marrëveshjes midis palëve. Sipas projektbuxhetit afatmesëm për vitet 2018 dhe 2019 ndaj kësaj studio ligjore janë programuar për t’u paguar edhe 210,310 mijë lekë (në total shuma e programuar 541,906 mijë lekë), *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 8-9, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22. Rekomandimi:

AKBN të marrë masa dhe në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit dhe shoqërinë “Albetrol” të rakordojnë pagesat e kryera duke krahasuar orët e punës të kryera në fakt me ato të programuara në kontratën e lidhur me studion ligjore, me qëllim bërjen transparente të punës së kryer sipas orëve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi. Për periudhën objekt auditimi AKBN ka paguar për çdo vit shumën prej 7,058,832 lekë për ruajtjen e kampioneve të puseve të naftës në tre ambiente të marra me qira nga P... në Fier. Pagesa për këtë ambient për një periudhë 10 vjeçare pas krijimit të AKBN me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)”, ka sjellë si pasojë që për një periudhë 10 vjeçare AKBN të shpenzojë për ruajtjen e mostrave shumën prej 70,588,320 lekë, e cila është e mjaftueshme për ndërtimin e një objekti në pronësi të AKBN dhe sipas kërkesave gjeologjike, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 8-9, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve konstatohet se për periudhën objekt auditimi AKBN rezulton me humbje e konkretisht:

Për vitin 2016 të ardhurat janë planifikuar në shumën prej 659,595 mijë lekë dhe shpenzimet 739,490 mijë lekë ose humbja është planifikuar në shumën prej 79,895 mijë. Në fakt të ardhurat janë realizuar në shumën prej 314,479 mijë lekë ose 47.6 % ndërsa shpenzimet janë realizuar në shumën prej 493,592 mijë lekë, ose shpenzimet janë realizuar më tepër se të ardhurat në shumën prej **179,113 mijë lekë**. Për të përballuar pagesat e mësipërme u përdor fondi prej 189 milionë lekë të arkëtuara nga detyrimet e prapambetura të KESH sh.a.

Për vitin 2017 të ardhurat janë planifikuar në shumën prej 870,894 mijë lekë dhe shpenzimet 840,186 mijë lekë ose fitimi për këtë vit është programuar në shumën prej 30,708 mijë. Në fakt të ardhurat janë realizuar në shumën prej 505,977 mijë lekë ose 58% ndërsa shpenzimet janë realizuar në shumën prej 573,581 mijë lekë, ose shpenzimet janë realizuar më tepër se të ardhurat në shumën prej **67,604 mijë lekë**. Për mbulimin e shpenzimeve të cilat kanë afat kohor të kufizuar dhe për shlyerjen e tyre AKBN-ja kishte mungesë likuiditeti dhe financimi i tyre u realizuar nëpërmjet huas nga Albpetrol sh.a. në shumën 80 milionë lekë, me të cilën u paguan shpenzimet e arbitrazhit.

Ndonëse për vitet 2016 dhe 2017, aktiviteti financiar është me humbje, kjo nuk ka penguar që titullarët të nxjerrin urdhra për shpërblimin e administratës me nga një pagë mujore për çdo vit në shumën totale 22.4 milionë lekë. Këto shpërblime nuk justifikohen, pasi performanca financiare për dy vitet rezulton me humbje në shumën prej 246,717 mijë lekë, çka tregon se shpërblimi ka thelluar akoma më shumë humbjen e institucionit, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet 4-7, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23. Rekomandimi (për pikën 24 dhe 25):

AKBN, të arrë masa për të kufizuar shpenzimet, për shpërblimet e pajustificuara, duke e lidhur shpërblimin me rezultatin vjetor dhe performancës e secilit punonjës, ndërsa për shpenzimet që kryen çdo vit për qira objekti të merren masa për të sistemuar kampionet e puseve të naftës duke ulur numrin nga 3 në 2, ose mundësisht në një magazinë të vetme, apo edhe nëpërmjet programimit të investimeve “Ndërtim objekti” për rritjen e kapaciteteve të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Në vijimësi

C. REKOMANDIME PËR MASA ZHDËMTIMI

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i kryer për shfrytëzimin e burimeve minerare në lidhje me prodhimin e nxjerrë dhe të shitur, në të ardhurat e deklaruara nga subjektet dhe të pasqyruara në evidencat e viteve 2016 dhe 2017 dhe dërguar në Ministrinë e Energjetikes dhe Industrisë (MEI) u konstatuan pasaktësi në të dhënat e evidencës statistikore, pasi evidenca vjetore për veprimtarinë e aktivitetit prodhues dhe tregtar të shoqërive që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar nuk është plotësuar me të gjithë treguesit kryesorë të prodhimit, të shitjes, të ardhurat e realizuara dhe renta e paguar, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, pasi:

a. 107 subjekte kanë deklaruar prodhim dhe kanë deklaruar të ardhura, por nuk kanë deklaruar shitje dhe rentën të paguar, duke sjellë si pasoj të ardhura të pa deklaruara dhe evazion fiskal në shumën prej **157,428,769 lekë**.

b. 9 subjekte kanë deklaruar dhe llogaritur gabimisht rentën minerare duke sjellë si pasoj evazion fiskal në shumën prej **198,698 USD**.

c. Në të gjitha lejet e rinovuara dhe të miratuara në asnjë rast AKBN nuk ka përcaktuar tarifën e rentës minerare sipas prodhimit që nxirret dhe shitet në fakt, kjo mënyrë organizimi është në kundërshtim me ligjin nr. 0304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, KREU VII, neni 40 “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” dhe neni 43 pika 5 ku përcaktohet se:

Struktura përgjegjëse (AKBN) ka të drejtë të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë ka dyshime se ai përdor praktika të dëmshme kërkimi, zbulimi apo shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, për respektimin e standardeve mjedisore të pranuar, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, **për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.**

AKBN, ndonëse ka konstatuar pasaktësi në deklaratimet e subjekteve nuk ka marrë asnjë masë për detyrimin e subjekteve të deklarojnë të dhënat e prodhimit dhe të rentës të vërtetuara me dokumente ligjore si, fatura shitje dhe deklaratat tatimore për rentën e paguar me qëllim kryqëzimin e të dhënave midis dy institucioneve sipas aktmarrëveshjes ndërinstitucionale të lidhur në zbatim të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave nr. 9689, datë 06.11.2015. Mosrespektimi i këtij kushti ka sjellë si pasojë që renta minerare të përcaktohet dhe llogaritet sipas dëshirës së subjekteve që shfrytëzojnë pasurinë kombëtare, duke sjellë evazion fiskal të konsiderueshëm në të ardhurat buxhetore, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 68-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1. Rekomandimi:

Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave dhe marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, Drejtoria Minerare nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të marrin masa për të njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave, për të kërkuar rilogaritjen dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale të pa deklaruara apo të llogaritur gabim respektivisht nga:

a. 107 subjekte që kanë deklaruar të ardhura nga shitja e prodhimit por nuk kanë deklaruar rentë minerale të paguar duke sjellë si pasojë të evazion fiskal në shumën prej **157,428,769 lekë**, *(shih listën bashkëlidhur raportit përfundimtar).*

b. 9 subjekte kanë deklaruar dhe llogaritur gabimisht rentën minerare duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat buxhetore në shumën prej **198,698 USD**, *(shih listën bashkëlidhur raportit përfundimtar).*

Menjëherë

Ç. MASA PËR ELIMINIMIN E KOSTOVE TË TEPËRTA TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE DHE PËR TË ARDHURAT E PA HYRA NË BUXHETIN E SHTETIT, PËR ADMINISTRIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË BURIMEVE NATYRORE.

Ç.1. Për, Licencë Marrëveshjen dhe Marrëveshjen Hidrokarbure me kompaninë Bankers Petroleum, Albania (B..) për vendburimin e naftës Patos-Marinës:

1. Gjetje nga auditimi. Për vitin 2016, shpenzimet e kryera për operacionet hidrokarbure nuk mbulohen nga të ardhurat e përfituara nga shitja e naftës, dhe për këtë vit kompania rezulton me humbje prej 16,261 mijë USD, dhe faktor R ka dalë, 0,902, pra më i vogël se 1. B.. nga data efektive e marrëveshjes deri në fund të vitit 2016 ka akumuluar humbje në masën 218,226 mijë USD, për pasojë nuk ka paguar në asnjë vit fiskal që nga viti 2004 deri në vitin 2016, tatim mbi fitimin në favor të buxhetit të shtetit. Për vitin 2017 të ardhurat e arkëtuara nga shitja e naftës bruto tejkalojnë shpenzimet e kryera për operacionet hidrokarbure dhe për këtë vit kompania rezulton me fitim prej 22,541 mijë USD, dhe faktor R del, 1.148, pra më i madh se 1. Që nga data efektive e marrëveshjes në vitin 2004 dhe deri në fund të vitit 2017 B.. ka akumuluar një humbje të mbaruar prej 195,688 mijë USD dhe faktor R është 0.9345, pra më i vogël se 1, për pasojë edhe për këtë vit nuk ka paguar tatim mbi fitimin. Për periudhën janar-qershor 2018 të ardhurat e arkëtuara nga shitja e naftës bruto tejkalojnë shpenzimet e kryera për operacionet hidrokarbure për këtë periudhë kompania rezulton me fitim prej 15,729 mijë USD, dhe faktor R del, 1.176, pra më i madh se 1. Që nga data efektive e marrëveshjes deri në fund të qershorit 2018, B.. mbart një humbje të akumuluar në masën 179,959 mijë USD. Kjo humbje në krahasim

me humbjen që ishte në fund të vitit 2017 prej 195,688 mijë USD është rikuperuar duke u zbritur në vlerë 15,729 mijë USD.

Për të mbikëqyrur dhe monitoruar kostot hidrokarbure të kryera nga B., në licencë marrëveshje është përcaktuar se, B.. ka detyrimin të dërgojë AKBN-së: *“jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo Periudhe 6 (gjashtë) mujore të LICENSUAR-i (B..L) i dorëzon AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë Kostot Hidrokarbure që i LICENSUAR-i realizoi gjatë asaj Periudhe 6 (gjashtë) mujore. Dokumentacioni llogaritës i dhënë nga i LICENSUAR-i do të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar AKBN të përcaktojë rregullsinë e Kostove Hidrokarbure të realizuara”*. B.. nuk ka dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve të llogarive që pasqyrojnë me hollësi Kostot Hidrokarbure (shpenzimet e kryera) që i ka realizuar gjatë, 6 (gjashtë) mujorit të 2 (dytë) të vitit 2016, gjatë 6 (gjashtë) e mujorit të 1(parë) dhe të 2 (dytë) të vitit 2017 dhe 6 (gjashtë) e mujorit të 1(parë) të vitit 2018. Ky problem është trajtuar gjerësisht në auditimet e mëparshme të KLSH dhe për eliminimin dhe rregullimin e kësaj parregullsie është dalë dhe me rekomandimin përkatës. Por me gjithë insistimin e AKBN për të zbatuar këtë rekomandim të KLSH dhe këtë kërkesë të MH, përsëri nga B.. nuk janë dërguar në AKBN kopje të dokumentacioneve që pasqyrojnë me Kostot Hidrokarbure të kryera për periudhat e sipërcituara. Për këtë shkak, përsëri edhe ky auditim, në kushtet e mungesës së këtij dokumentacioni, u krye në bazë të evidencave dhe situacioneve (progres raporteve) periodike të kostove hidrokarbureve që B.. i ka dërguar në AKBN në çdo tremujor për të llogaritjen e faktorit R. Megjithatë mbështetur në këto situacione, dhe bazuar në të dhënat dhe vlerat e pasqyruara dhe në dokumentet mbështetëse të raporteve të auditimit që struktura e Auditimit të AKBN kanë audituar B.. për vitet 2013 dhe 2014 dhe në projektraportin e vitit 2015 të ushtruar në vitin 2018, kemi nxjerrë në dukje disa kosto hidrokarbure të cilat janë kryer në kundërshtim me Aneksi B neni 2 i Marrëveshjes Hidrokarbure dhe me neni 10.2 të Licencë Marrëveshjes, më poshtë vijon:

1.1. Gjetje nga auditimi. Kompania B., për shtijën e naftës bruto që para vitit 2016 ka pasur kontrata të lidhura me nën kontraktorët vendas, konkretisht me shoqërinë A.. dhe shoqërinë D... Këto dy shoqëri nuk i kanë shlyer detyrimet financiare kundrejt B.. për shitjen e naftës në vlerën totale 17,099,147 USD. Të dyja këto dy shoqëri aktualisht nuk kryejnë më aktivitet tregtar sepse kanë falimentuar para vitit 2016 dhe B.. edhe pse ka ndjekur procedurat ligjore për të kërkuar shlyerjen e këtij detyrimi nuk ka mundur të arkëtojë këtë detyrim por e ka pasqyruar vlerën 17,099,148 USD si borxh të keq dhe në kundërshtim me Aneksi B të MH dhe me neni 10.2 të LM e ka konsideruar të ardhurat e munguara nga shitja e naftës. Këtë veprim e ka bërë me qëllim që vlera prej 17,099,148 USD të njihet si kosto hidrokarbure, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1.Rekomandimi:

AKBN, të mos njohë si kosto hidrokarbure të rikuperueshme vlerën 17,099,148 USD dhe të rillogarisë Faktorin R duke e zbritur këtë vlerë nga shpenzimet totale të akumuluar.

Me dorëzimin e progres raporteve të tremujorit të katër të vitit 2018

1.2. Gjetje nga auditimi. Shoqëria B., ka pasur kontrata të lidhura me nën kontraktorët BP Oil për shitjen e naftës bruto. Në vitin 2015, B.. ka prishur kontratën me këtë shoqëri. Si pasojë e ndërprerjes së kontratës kompania B.. ka paguar për shpenzime ligjore dhe gjyqësore vlerën 4,714,803 USD si dhe ka dëmshpërblyer shoqërinë B.O me në vlerën 16,500,050 USD. Vlerën totale prej 21,214,853 USD në kundërshtim me Aneksi B të MH dhe me neni 10.2 të LM e ka konsideruar si kosto hidrokarbure, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.2.Rekomandimi:

AKBN, të mos njohë si kosto hidrokarbure të rikuperueshme vlerën 21,214,853 USD dhe të rillogarisë Faktorin R duke e zbritur këtë vlerë nga shpenzimet totale të akumuluar.

Me dorëzimin e progres raportit të tremujorit të katër të vitit 2018

1.3. Gjetje nga auditimi. Shoqëria B., që para vitit 2016, ka pasur disa kontrata të lidhura për marrje me qira të tokave dhe shpenzimet e qirasë i ka pasqyruar si kosto hidrokarbure. Të gjitha këto kontrata ndodhen brenda zonës së kontratës dhe B.. edhe për vitet 20016, 2017 dhe 2018 i ka në fuqi dhe në zbatim këto kontrata. Kështu, mbi bazën e këtyre kontratave, në vitin 2016, ka

pasqyruar si kosto hidrokarbure shpenzime për qiratë e tokave vlerën prej 6,840,000 USD, në vitin 2017, ka pasqyruar si kosto hidrokarbure vlerën prej 6,393,000 USD dhe në periudhe janar-qershor 2018 ka pasqyruar si kosto hidrokarbure vlerën prej 3,350,000 USD. Duke ju referuar raportit të auditimit për auditimin e kryer nga AKBN gjatë vitit 2017 për aktivitetin e B.. të vitit 2014 dhe me projektreportin për auditimin e kryer gjatë vitit 2018 për aktivitetin e B.. të vitit 2015, AKBN nuk ka njohur si kosto hidrokarbure vlerat e dala si pasojë e diferencës së çmimeve të qerasë së tokave që janë mbi vlerën e tregut lokal. Konkretisht nuk ka njohur 2,800,000 USD për vitin 2014 dhe 4,900,000 USD për vitin 2015. Mos njohja e këtyre vlerave si kosto të parikuperueshme, siç u tha më sipër është mbështetur, bazuar dhe është trajtuar në të njëjtin interpretim, arsyetim dhe logjikë si në rezultatet e auditimit të fundit të KLSH në të cilin është lënë rekomandim për mosnjohje si kosto hidrokarbure të rikuperueshme rreth 17,600,000 USD që ka të bëjë me diferencat e çmimeve të qirasë së tokave mbi çmimet e tregut. Në mungesë të dokumentacionit dhe në mbështetje të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit “ISSAI 1610” (trajtuar me sipër në pikën B.1.4), morëm në konsideratë të dhënat e raporteve të auditimit të kryera nga auditimin i brendshëm i AKBN, në lidhje me shpenzimet e qirasë së tokave dhe po i trajtojmë ato edhe për periudhën që është objekt i auditimit tonë e rezultoi se, rritja e kostove hidrokarbure si pasojë e kontratave të lidhur për marrje me qira të tokave bujqësore mbi çmimet e tregut lokal, për gjithë periudhën janar 2016 deri në qershor 2018 është në shumën e përgjithshme afërsisht 11,800,000 USD. Po kështu duke marrë në konsideratë edhe raporte e auditimit të kryera nga AKBN për vitin 2014 dhe për vitin 2015 në të cilat nuk janë konsideruar dhe nuk janë njohur si kosto hidrokarbure e rikuperueshme shpenzimet e tepërta të qirave të tokës bujqësore mbi çmimet e tregut lokal, në vlerën totale 7,000,000 USD, rritja e këtyre shpenzimeve që kanë sjell efekte në uljen e Faktorit R, dhe pjesës së fitimit që i takon Albpetrolit, është rreth 18,880,000 USD, (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 16-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.3. Rekomandimi:

AKBN, në auditimet që do të kryhej në B.. për vitet 2016, 2017 dhe 2018, duhet të saktësojë shpenzimet e parikuperueshme e mësipërme të llogaritura në vlerën totale rreth 18,800,000 USD, duke vlerësuar në mënyrë të kujdesshme devijimet anormale nga çmimet e tregut dhe në fund të çdo periudhe të rillogarisë Faktorin R.

Në vijimësi, në çdo progres raporti tremujor

2. Gjetje nga auditimi. B.., që para vitit 2016, ka pasur disa kontrata të lidhura për marrje me qira të ambienteve të banimit dhe shpenzimet e qirasë i ka pasqyruar si kosto hidrokarbure. Këto kontrata edhe për vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë në fuqi dhe në zbatim. Duke ju referuar raportit të auditimit për auditimin e kryer nga AKBN gjatë vitit 2017 për aktivitetin e B.. të vitit 2014 dhe të vitit 2015, nuk ka njohur si kosto hidrokarbure vlerat e dala si pasojë e diferencës së çmimeve të qerasë së banesave që janë mbi vlerën e tregut lokal. Konkretisht nuk ka njohur 470,000 USD për vitin 2014 dhe 470,000 USD për vitin 2015. Ashtu si në rastet e qirave të tokave bujqësore, mos njohja e këtyre vlerave si kosto të parikuperueshme është mbështetur, bazuar dhe është trajtuar në të njëjtin interpretim, arsyetim dhe logjikë si në rezultatet e auditimit të fundit të KLSH në të cilin është lënë rekomandim për mosnjohje si kosto hidrokarbure të rikuperueshme rreth 3,700,000 USD që ka të bëjë me diferencat e çmimeve të qirasë së banesave mbi çmimet e tregut. Ndërsa, për gjithë periudhën objekt të këtij auditimi, janar 2016 deri në qershor 2018, rezultoi se, kostot hidrokarbure si pasojë e çmimeve mbi çmimet e tregut të qirasë së banesave dhe të referencave ligjore në fuqi, janë rritur në shumën e përgjithshme afërsisht 650,000 USD. Në mungesë të dokumentacionit dhe në mbështetje të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit “ISSAI 1610” morëm në konsideratë edhe raportet e auditimit të AKBN për vitin 2014 dhe 2015 në të cilat nuk janë njohur si kosto hidrokarbure e rikuperueshme shpenzimet e tepërta të qirave së banesave mbi çmimet e tregut lokal, në vlerën totale 940,000 USD, rritja e këtyre shpenzimeve që ka sjell efekte në uljen e Faktorit R, dhe pjesës së fitimit që i takon Albpetrolit, është në vlerën totale rreth 1,590,000 USD, (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 22-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.Rekomandimi:

AKBN, gjatë auditimeve që do të kryhej në B.. për vitet 2016, 2017 dhe 2018 duhet të saktësojë dhe përcaktojë shpenzimet e parikuperueshme e mësipërme në vlerën totale rreth 1,590,000 USD, duke vlerësuar në mënyrë të kujdesshme devijimet anormale nga çmimet e tregut dhe në fund të çdo periudhe të rillogarisë Faktorin R.

Në vijimësi, në çdo progres raporti tremujor

3. Gjetje nga auditimi. Kompania B.. në përputhje me Nenin 21.2 të MH, duhet të bëjë tender konkurrues për kontratat që tejkalojnë 2,000,000 USD dhe për këto kontrata nuk ka vënë në dispozicion asnjë procedurë tenderuese. Referuar raporteve të auditimit të AKBN si dhe informacioneve të marra në AKBN rezultoi se, ashtu si në vitet e mëparshme dhe për këtë periudhe auditimi, B.. nuk ka zhvilluar procedura konkurruese për kontratat që i tejkalojnë vlerën mbi 2 milion lekë. Problematika lidhur me moskryerjen nga ana e B.. e procedurave tenderuese për përzgjedhjen e kontraktorëve, është trajtuar gjerësisht edhe në auditimet e viteve të mëparshme nga KLSH, po ashtu edhe nga vetë AKBN ku është konstatuar se, kompania B.. nuk kryen procedura tenderuese prej vitesh, një pjesë e të cilave që prej vitit 2005, duke i dhënë kështu, të drejtë ekskluzive për kryerjen e operacioneve hidrokarbur, vetëm pak operatorëve ekonomik. KLSH vlerëson së B.. i ka të gjitha kapacitetet njerëzorë, teknike e profesionale, konsulencat e nevojshme etj, për zhvillimin me standardet me të mira të industrisë së naftës për kryerjen e tenderëve konkurrues. Fakti që shoqëria B.. për disa shërbime ka kryer procedura tenderuese, nënkupton se, B.. ndjek praktikë me dy standarde për kryerjen e tyre. Në këtë kontekst kompania në mënyrë të vullnetshme ka dështuar në kryerjen e procedurave tenderuese. Në zbatim të pikës 10.2(c) të MH, kostot dhe shpenzimet të cilat janë kryer si rezultat i dështimit të vullnetshëm të të licencuarit ose operatorit, do të konsiderohen si kosto të parikuperueshme. Por në vlerësimin e KLSH, nuk do të konsideroheshin si kosto të parikuperueshme e gjithë vlerat e kontratave ashtu siç i ka konsideruar auditimi i AKBN, që për çdo vit që ka audituar nuk i njeh si kosto të rikuperueshme të gjithë vlerat e kontratave të lidhura pa procedurë konkurruese, ku vetëm për vitin 2014 nuk i ka njohur vlerën prej 184,507,119 USD dhe për vitin 2015 nuk i ka njohur vlerën prej 70,00,000 USD. AKBN është në të drejtën e saj për mos të njohur këto kosto hidrokarbure, sepse është përgjegjësi e saj të verifikojë nëse veprimtaria ekonomike e kontraktorit kryhet në respektim të parimeve të eficiencës së shpenzimeve duke qenë që vetë shteti shqiptar është palë dhe partner ekonomik në këtë veprimtarinë prodhuese. Në rast se, AKBN konstaton që B.. nuk i ka kryer kostot hidrokarbure në përputhje me MH dhe LM atëherë AKBN është e detyruar që të mos i llogarisë dhe certifikojë këto si kosto hidrokarbure. Megjithatë, KLSH, do të konsideronte, kosto të parikuperueshme vetëm mbi vlerat që janë kontraktuar për shërbime, punë dhe mallra me çmime mbi çmimet e tregut vendas. Mirëpo e ka të pamundur të llogarisë efektin e tepërt që vjen si pasoje e çmimeve mbi tregun sepse, B... nuk i ka dërguar dhe nuk i ka vënë në dispozicion AKBN, kontratat, faturat, pagesat dhe çdo dokument tjetër financiar që mbi bazën e tyre të llogarisim saktësisht efektet negative për këtë periudhë auditimi. Por, meqenëse në auditimin e fundit të KLSH dhe në auditimet e AKBN, janë konstatuar shpenzime të tepërta për shërbimin transportit dhe për disa zëra të punimeve civile si pasoje e çmimeve të kontraktuara mbi çmimet e tregut dhe referencave ligjore në fuqi, duke marrë në konsideratë që kontrata janë në zbatim me të njëjtat çmime edhe për vitet 2016, 2017 dhe 2018, po llogarisim më përafërsi, vetëm shërbimin e transportit të naftës dhe vlerën e punimeve civile. Shpenzimet për shërbimet e transportit vetëm për një vit fiskal janë rënduar me tepër afërsisht rreth 5 milion USD, ndërsa shpenzimet kapitale për punimet civile për një vit janë rritur afërsisht rreth 7 milion. Dhe për të gjithë periudhën janar 2016 deri në qershor 2018 këto shpenzime së bashku janë rritur afërsisht në vlerën 30 milionë USD, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 26-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Rekomandimi:

AKBN, gjatë auditimeve që do të kryhej në B... për vitet 2016, 2017 dhe 2018 duhet të saktësojë dhe përcaktojë shpenzimet e parikuperueshme e mësipërme në vlerën totale rreth 30,000,000 USD, duke vlerësuar në mënyrë të kujdesshme devijimet anormale nga çmimet e tregut dhe në fund të çdo periudhe të rillogarisë Faktorin R.

Në vijimësi, në çdo progres raporti tremujor

Ç.2. Për, Licencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimin e Delvinë:

4. Gjetje nga auditimi. Fillimisht kjo marrëveshje është lidhur midis kompanisë Albpetrol dhe S... dhe është miratuar me VKM Nr. 509, date 08/08/2007. Sipas marrëveshjes, kompania ka pasur detyrimin për kryerjen e investimeve kapitale, brenda 24 muajve në vlerën 1,500,000 USD për fazën e parë të kërkimit. Ndërsa, faza e dytë e kërkimit ishte opsionale dhe nëse kompania do të futej në fazën e dytë të kërkimit do të realizonte shpimin e një pusi brenda 36 muajsh, për të cilin ishte parashikuar një investim minimal prej 7 milion USD. Sipas marrëveshjes, kompania duhet të garantonte këtë investim në një bankë të nivelit të dytë, në emër të AKBN. Shuma e kësaj garancie do të reduktohej në çdo tremujor në një shumë të barabartë të investimit të kryer nga kompania, gjatë këtij tremujori. Mbas përfundimit të fazës së parë të kërkimit në shtator të vitit 2010, kompania u fut në fazën e dytë të kërkimit. Para futjes së fazës së dytë të kërkimit, kompania duhet të garantonte këtë investim në emër të AKBN, duke derdhur në një bankë të nivelit të dytë shumën e investimit prej 7,000,000 USD dhe kjo shumë do të reduktohej nga AKBN në çdo tremujor për aq sa kompania do të shpenzonte gjatë këtij tremujori.

Mirëpo nga auditimi u konstatua se, në respektim të MH, Albpetrol dhe AKBN, para fillimit të punës për fazën e dytë të kërkimit nuk i ka kërkuar kompanisë "S..." që të garantojë në bankë shumën e investimit minimal që të do të kryhej për këtë fazë prej 7 milion USD. Kompania ka vijuar me punimet për shpimin e pusit dhe në muajin shtator 2013, ka përfunduar fazën e dytë të kërkimit duke kryer vetëm 2,029,000 USD investime dhe më pas ka ndërprerë dhe braktisur punimet duke mos përfunduar fazën e dytë të kërkimit për vlerën e plotë të investimit prej 7 milion USD. Por, në zbatim të nenit 6.1 të MH, AKBN duhet ti kërkonte kompanisë që të derdhte për llogari të saj vlerën e investimit të mbetur që është 4,971,000 USD (7,000,000-2,029,000). Ky nen i MH përcakton qartazi se: ".....Nëse në përfundim të 36 muajve të fazës së dytë të kërkimit dështon të shpenzojë 7,000,000 USD, atëherë Kontraktori do ti pagojë AKBN një shumë të barabartë me pjesën e pa-realizuar të angazhimit financiar minimal". Por, shuma prej 4,971,000 USD nuk është bërë e mundur për tu arkëtuar sepse, nuk është garantuar në bankë investimit prej 7 milion USD.

Në vijim, në muajin prill të vitit 2015, interesat e kësaj marrëveshje (të gjitha të drejtat, privilegjet, detyrimet dhe përgjegjësitë) u transferuan në mënyrë të vullnetshme nga kompania S... "T...". Por, përsëri Albpetrol dhe AKBN para se të miratonte këtë marrëveshje nuk i kanë kërkuar kompanisë T.. që të garantojë investimin e mbetur për fazën e dytë të kërkimit në formën e garancisë bankare duke derdhur në bankë shumën 4,971,000 USD. Mbas lidhjes së marrëveshjes së transferimit, AKBN i ka kërkuar disa herë kompanisë "T.." shlyerjen e këtij detyrimi, por kompania nuk pati angazhim për shlyerjen e tij. Më pas, përsëri në mënyrë të vullnetshme interesat e kësaj marrëveshje, kaluan nga kompania "T..", të kompania "D... Ky transferim ka marrë miratim e AKBN me shkresë nr. 6871/1, datë 23.08.2016 dhe sipas kësaj marrëveshje kompania D.. njeh detyrimin për ti paguar AKBN vlerën prej 4,971,000 USD si detyrim i pa përmbushur nga kompania T... Për të mundësuar marrëveshjen e transferimit, ndërmjet AKBN dhe kompanisë D.. është nënshkruar një marrëveshje tjetër me nr. 7552, datë 22.08.2016 "Për shlyerjen me këste të detyrimit prej 4,971,000 USD. Por, kompania "D.. në kundërshtim me marrëveshjen nr. 7552, datë 22.08.2016 "Për shlyerjen me këste të detyrimit" deri në periudhën e auditimit në muajin tetor 2018 ka shlyer vetëm një pjesë të detyrimit në shumën 1,120,689 USD nga 2,783,741 USD që detyrohej të shlyente deri në këtë periudhë. Ndërsa pjesën tjetër të detyrimit të mbetur prej 1,663,052 USD, me gjithë kërkesat e herëpashershme të AKBN për të arkëtuar këtë detyrim, kompania për mungesë financimi nuk e ka paguar ende këtë detyrim. AKBN si pasoj e mungesës së garancisë së investimit, e ka të pamundur të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme marrëveshjen dhe të ndërmarr të gjitha mjetet ligjore për marrjen forcërisht të detyrimit të njohur dhe të papaguar në shumën e mbetur prej 4,134,000 USD. Pra, kompania fillimisht ka respektuar marrëveshjen për shlyerjen me këste të detyrimit dhe më pas, për pamundësi financiare ka pezulluar pagesat duke mos respektuar këstet e radhës së kësaj marrëveshjeje. Por, me shkresën nr. 7386, datë 17.08.2016

njofton AKBN se, kompania refuzon paraqitjen e garancisë bankare sepse kjo kërkesë nuk parashikohej në LM apo MH në fazën në të cilën kanë lidhur marrëveshjen e transferimit, pra nuk kemi të bëjmë me fazën e kërimit, sepse kjo fazë ka përfunduar që në vitin 2013, por kemi të bëjmë me një detyrim të mbartur disa vite më parë nga dy komani të tjera. Njëkohësisht në këtë shkresë është shprehur se, e njëjta detyrim dhe merr angazhimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e transferimit dhe marrëveshja për shlyerjen me këste të këtij, (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 46-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Rekomandimi:

AKBN, duhet të gjejë rrugët e bashkëpunimit me kompaninë “D.., dhe njëkohësisht të ndjekë të gjitha procedurat administrative duke shteruar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga, Marrëveshja Hidrokarbure, Licencë Marrëveshja dhe Marrëveshja e Transferimit për të bërë **të mundur shlyerjen e detyrimit prej 4,134,000 USD**, sipas radhës së përcaktuar në Marrëveshjen “Për shlyerjen me këste të detyrimit”, apo në mirëkuptim mes tyre të bëjnë ristrukturimin e këtij detyrimi për të shtirë shlyerjen e tij me këste, me afate kohore më të gjata.

Në vijimësi

Ç.3. Për shfrytëzimi i burimeve minerare:

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave të AKBN për periudhën objekt auditimi 9 subjekte zotërojnë leje me objekt “Shfrytëzim minerali Gips-Alabastër” të cilët kanë prodhuar dhe shitur gjithsej 235,026 ton mineral. Për këtë sasi, renta minerare është llogaritur me tarifën 21 lekë/ton dhe jo e diferencuar sipas raportit që zë “Alabastra” ndaj njësisë së volumit, për të cilën renta minerare është përcaktuar me tarifën 423 lekë m³. Mos llogaritja e kësaj tarife për peshën specifike që zë “Alabastra.” ndaj njësisë së volumit sjell të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Nga verifikimi me zgjedhje i kryer në dokumentacionin e disa subjekteve që zotërojnë leje minerare me objekt shfrytëzimi “GipsitAlabastra”, u konstatua:

Subjekti “A....” me lejë shfrytëzimi nr. 1433/1, datë 11.09.2009 në zonën Mengaj Kavajë, sipas lejes minerare shfrytëzon mineral “Gips Alabastër” të bardhë me ngjyrë qumështi me përbërje CaSO₄ në masën prej 95.74 % dhe 2H₂O 4.26 %. Ndonëse kjo përqindje e bën mineralin të përshtatshëm për prodhimin e çimentos “Portland” apo të markave të tjera më të larta dhe prodhime të reja (çimento e bardhë), në dokumentacionin që administrohet në dosjen e këtij subjekti nuk u gjenden të dhëna për raportin që zë “Alabastra” në njësinë e volumit të prodhimit të nxjerrë. Nga të dhënat që administrohen në dosjen e monitorimit të këtij subjekti dhe në raportin tekniko-minerar të kësaj zone sipas të dhënave të deklaruara nga vetë subjekti cilësohet se: *“aktualisht në vendburim (periudha e monitoruar) janë hapur rreth 25,000 ton alabastër”* (cilësim nga vetë subjekti). Përcaktimi i raportit midis mineralit të “Gipsit” dhe “Alabastres” në raport ndaj njeri tjetrit dhe përqindjes që zënë këto elementë në njësinë e volumit “1 m³” është përcaktues për llogaritjen e rentës së prodhimit të shitur, pasi elementët (gipsi dhe alabastra) sipas ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar kanë rentë të ndryshme. Kështu, në shtojcën nr. 2 të grupit IV “Minerale ndërtimi”, renta minerare për “Gipsin” është 21 lekë/ton dhe për “A....”, renta minerare është 423 lekë/m³, ose 20 herë më tepër se gipsi. Nga auditimi konstatohet se, vlerësimi i prodhimit të nxjerrë dhe të shitur është bërë me njësi matje të ndryshme e konkretisht, “Gipsi” është vlerësuar me njësinë “Ton” ndërsa “Alabastra ” është vlerësuar me njësinë “m³”. Sipas sistemit ndërkombëtar “SI” për të dy këta elementë renta duhet llogaritur në njësi të barabarta ose në ton ose m³, e theksojmë këtë fakt, pasi të dy këta elementë janë pjesë përbërëse e të njëjtit material.

Sipas sistemit SI, peshës specifike e mineralit “Gips alabastër” për njësinë e matjes 1 cm³ është e barabartë me 2.2 gram dhe pesha për volumin 1 m³ është e barabartë me 2.2 ton.

Nga të dhënat e paraqitura në programin financiar dhe realizimi i treguesve të vitit 2016 konstatohet se, shoqëria ka nxjerrë dhe shitur gjithsej 21.240 ton mineral “Gips alabastër” për të cilën ka llogaritur dhe deklaruar rentë me tarifën 21 lekë/ton në shumën prej 368,421 lekë. Sipas

prodhimit të shitur renta në fakt duhej llogaritur në shumën prej 446,040, lekë, ose renta minerare është llogaritur më pak për shumën 77,619 lekë.

Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” shtojca nr. 2 renta për mineralin “Alabastër” është përcaktuar me tarifën prej 423 lekë/ton. Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria Minerare sipas programit të punës për këtë produkt nuk ka asnjë të dhënë teknike-gjeologjike për raportin që zë alabastra ndaj njësisë ndonëse në rastin konkret alabastra është pjesë përbërëse e mineralin e përbashkët “Gips-Alabastër”.

Sipas të dhënave të subjektit në programin financiar si për vitin 2016, 2017 ashtu edhe në miratimin e lejes për periudhën 2018-2019 deklarohet një volum prej 50,000 ton alabastër (respektivisht 25,000 ton çdo vit), e konvertuar në sasinë prej 11,363 m³ (1 cm³=2.2 gr), për këtë volum renta minerare për vitin 2016 duhej të llogaritej në shumën prej 4,806,549 lekë (11,363 * 423), po kështu edhe për vitin pasardhës 2017-2018 renta minerare për “Alabastrën” duhet të llogaritej e veçantë në shumën prej 4,806,549 lekë.

Për sa më lart mos llogaritja e rentës minerare për elementin “Alabastër” me tarifën prej 423 lekë/m³, ka sjellë të ardhura të munguara për dy vite në buxhetin e shtetit në shumën prej 9,613,000 lekë.

Nga të dhënat e programit financiar të depozituar në AKBN, subjekti ka deklaruar dhe llogaritur koston për njësi të prodhimit të “Gipas Alabastër” në shumën prej 200.70 lekë/m³, çmimi i shitjes për këtë mineral është realizuar 950 lekë/m³, me një fitim bruto në shumën prej 750 lekë/m³. Po këto mangësi u konstatuan edhe në subjektin “Inte” që zotëron leje minerali për shfrytëzim “Gips –Alabastër”.

Për periudhën objekt auditimi 9 subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi “Gips-Alabastër” kanë nxjerrë dhe shitur gjithsej 236,000 ton mineral dhe renta për këtë sasi është llogaritur me tarifën 21 lekë/m³ dhe jo e diferencuar me tarifën prej 423 lekë/ton të përcaktuar në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 9975, datë 20.08.2008, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-62,të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. Rekomandimi:

AKBN, të marrë masa dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë mostra dhe kampione në vend shfrytëzimet e mineralit “Gips Alabastër” me qëllim kryerjen e analizave dhe përcaktimin e raportit që zë Gipsi dhe Alabastra në kampionet që do analizohen me qëllim diferencimin e tarifës për mineralin “Gips” dhe veçimin e mineralit “Alabastër” sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Nëpërmjet këtij ndryshimi në raportin që zë alabastrin ndaj totalit të mineralit, të ardhurat buxhetore **do të rriten në vlerën 29,600,000 lekë (70,000 ton x 423 lekë/ton)**.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi konstatohet se një numër i konsiderueshëm i subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi material ndërtimi dhe kryesisht “Gurë pllakorë dekorativë” objekti i shfrytëzimit të mineralit të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit dhe të miratuar nga Ministri nuk përputhet me kategorinë dhe llojin e mineralit që shfrytëzohet në fakt; kështu përmendim mineralin “Gurë pllakorë gëlqerorë”, të cilat sipas të dhënave të monitorimit në terren rezultojnë “Gurë gëlqerorë pllakorë të mermerizuar”.

Deklarimi dhe llogaritja e rentës nga vetë subjektet është bërë në kundërshtim me shtojcën nr. 2 “Materiale ndërtimi” bashkëlidhur ligjit nr. 141/ 2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, për këto pasaktësi megjithëse AKBN ka dërguar shkresë Ministrin e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Ministrin e Financave, ky problem deri sot nuk ka gjetur zgjidhje duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Nga auditimi i të dhënave që disponohen në dosjet e subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimit të mineralit “Gurë pllakorë të kategorive të ndryshme” dhe sipas vlerësimit teknik dhe gjeologjik konstatohet se të gjitha kategoritë e gurëve dekorativë pllakorë dhe kristalorë kanë veti mekanike, kimike, porcelanore deri në perfeksion, nga të cilat përfitohen pllaka me dimensione dhe trashësi që i përgjigjen tregut të jashtëm.

Cilësitë e këtyre kategorive paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Treguesit kimike, fiziko mekanike të gëlqerorit në %	Totali në %
----------	--	-------------

	CAO	Fe ₂ O ₃	MgO	Al ₂ O ₃	SiO ₂	HK	
Gur pllakor kristalor	52.92	1.65	1.51	0.29	1.82	41.46	99.65
Gur pllakor gëlqeror	52.92	1.65	1.51	0.29	1.82	41.46	99.65

Nga tabela konstatohet se, treguesit kimike, fiziko mekanike janë të barabarta, ndryshimi i vetëm për këto kategori minerale është vetëm në rezistencën për cm², kështu: rezistenca në shtypje e gurit pllakor kristalor (mermer) varion nga 1120 kg/cm² deri në 1310 kg/cm², ndërsa guri pllakor gëlqeror rezistencën në shtypje e ka nga 986 kg/cm² deri 1110 kg/cm². Parametrat tekniko-kimike tregojnë se këto materiale kanë karakteristika të fiziko-kimike të njëjta me përjashtim të rezistencës materiale, çka do të thotë që edhe renta duhet të jetë në funksion të rezistencës materiale, duke filluar nga pllaka guri ranor silicor me tarife 1,456 lekë/m³ deri tek tarifat për “Pllaka guri mermerizuara kristalor” nga 4,550 lekë/m³ dhe 6,000 lekë/m³ për “pllaka të tjera” guri dekorativ.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, të gjithë subjektet kanë deklaruar rentën për prodhimin e nxjerrë dhe të shitur me tarifë 228 lekë/m³ që i përket grupit IV “Materiale Ndërtimi” me emërtimin “Pllaka guri”, dhe jo me tarifë të diferencuar sipas kategorisë dhe rezistencës materiale të pllakave dekorative (për këtë kategori në asnjë rast nuk u gjenden të dhëna për përbërjen fizike, kimike, mekanike dhe rezistencën), të cilat kanë rentë të diferencuar si më poshtë:

- “Pllaka Guri”, renta minerare 228 lekë/m³;
- “Pllaka Ranore”, renta minerare 1,456 lekë/m³;
- “Pllaka Graniti”, renta minerare 6,228 lekë/m³;
- “Pllaka Mermeri”, renta minerare 4,550 lekë/m³;
- “Pllaka të tjera”, renta minerare 6,000 lekë/m³.

Për periudhën objekt auditimi volumin më të madh të prodhimit dhe të të ardhurave e realizojnë 85 subjekte private që zotërojnë leje shfrytëzimi për “gurë pllakorë gëlqerorë”, “Gurë pllakorë të mermerizuar”, “Gurë ranorë silicorë” dhe traktolite. Kjo veprimtari ushtrohet respektivisht nga: 33 subjekte zotërojnë leje për “Gurë gëlqerore pllakorë të mermerizuar”, 25 subjekte për Gurë pllakorë gëlqerorë” dhe 27 subjekte zotërojnë leje për “Gurë ranorë silicorë” të cilët kanë prodhuar dhe shitur prodhimet sipas kategorive të mëposhtme:

a. Për periudhën objekt auditimi janë shitur brenda vendit dhe janë eksportuar gjithsej 40,000 m³ “Pllaka guri të mermerizuar” për të cilat renta minerare është deklaruar dhe llogaritur nga subjektet shfrytëzuese me tarifën 228 lekë/m³ dhe jo e diferencuar sipas kategorive dhe llojit të pllakave dekorative sipas shtojës nr. 2 bashkëlidhur ligjit për Taksat kombëtare. Ndonëse subjektet kanë deklaruar rentën minerare, por në asnjë rast grupet e monitorimit të Drejtorisë Minerare të AKBN-së nuk kanë bërë verifikimin e rentës së deklaruar me llojin e pllakave të prodhuara dhe të shitura sipas kategorive të përcaktuara në ligjin për Taksat Kombëtare.

Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me tarifat sipas kategorive të përcaktuara në grupin IV “Materiale Ndërtimi”, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 i ndryshuar, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 172,800,000 lekë $\{(40,400 \text{ m}^3 \times (4,550-228))\}$

b. Për periudhën objekt auditimi janë shitur brenda dhe janë eksportuar gjithsej 98,100 m³ “Pllaka guri gëlqerore dekorativë” për të cilat renta minerare është deklaruar dhe llogaritur nga subjektet shfrytëzuese me tarifën 228 lekë/m³ dhe jo e diferencuar sipas kategorive dhe llojit të pllakave dekorative respektivisht pllaka ranore silicore me tarifën prej 1,456 lekë/m³, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 120,400,000 lekë $\{(98,100 \text{ m}^3 \times (1,456-228))\}$.

c. Për periudhën objekt auditimi janë nxjerrë dhe shitur 12,100 m³ “Pllaka ranore-silicore”, për të cilat renta minerare është llogaritur me tarifën 228 lekë/m³ dhe jo me tarifën prej 1,456 lekë m³, mos respektimi i tarifave të përcaktuara në ligjin nr. 9975, datë 27.07.2008 ka sjellë si pasojë të ardhura të munguara për këtë mineral në shumën prej 14,800,000 lekë. $\{(12,100 \text{ m}^3 \times (1,456-228))\}$.

Si konkluzion për tre këto kategori “guri pllakor dekorativ të gëlqerizuar dhe kristalor”, si rrjedhje e mosrespektimit të tarifave të përcaktuara në ligjin nr. 9775, date 20.08.2008, **buxhetit**

të shtetit nuk i kanë hyrë të ardhura në shumën e përgjithshme prej 308,000,000 lekë, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4...., në faqet 62-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Rekomandimi:

Në zbatim të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave dhe marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, Drejtoria Minerare nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të ushtojnë kontroll fizik për prodhimin e shitur me qëllim rakordimin e rentës minerare të deklaruar nga subjektet dhe rentës minerare që duhet të paguhet sipas llojit të prodhimit (gur dekorativ pllakor), pasi tarifën për këtë llojshmëri prodhimi fillojnë nga minimalja 228 lekë/m³ deri tek maksimale 4,550 lekë m³. Kjo mënyrë veprimi do ndikojë në rritjen e të ardhurave buxhetore, të cilat vetëm nga ky auditim ***llogariten rreth 308,000,000 lekë*** sepse çdo subjekt që zotëron lehtë shfrytëzimi për gurë dekorativë duhet të paguajë rentën minerare sipas llojit të prodhimit që nxjerr dhe shet në fakt.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i kryer në dosjen e subjektit privat me leje nr. 999/1 “Shpresa al” në zonën e shfrytëzimit Picrrage, Kruje, me objekt “Prodhim gurë gëlqeror për çimento” për vitin 2016 subjekti ka deklaruar të ardhurat në shumën prej 196,800,724 lekë, duke realizuar një çmim mesatar prej 813.3 lekë/m³. Sipas kësaj tablele, subjekti ndonëse ka realizuar të ardhura nuk rezulton të ketë deklaruar prodhim dhe shitje minerali. Nga verifikimi i kryer në të dhënat që administrohen në dosjen e monitorimit të subjektit dhe në tabelën e hartuar nga AKBN konstatohet se subjekti ndonëse nuk ka deklaruar sasinë e prodhimit dhe të shitjes ka deklaruar rentë të paguar në shumën prej 1,778,956 lekë. Sipas këtyre të dhënave dhe nga llogaritjet e kryera nga grupi i KLSH-së sasia e prodhimit dhe shitjes që i korrespondon të ardhurave do të jete në sasinë prej 241,978 m³ (196,800,724: 813.3)

Nga këto të dhëna Grupi i auditimit konstaton se nga të ardhurat e deklaruara në shumën prej 196,800,724 lekë, me çmimin prej 813.3 lekë/m³, shoqëria “Sh...” duhet të raportonte shitjen prodhimin dhe shitjen në sasinë prej 241,978 m³.

Në këtë rast për volumin e prodhimit të shitur prej 241,978 m³ renta që shoqëria “Sh...” duhet të deklaronte dhe të paguante do të ishte në shumën prej 11,372,966 lekë, në fakt shoqëria ka paguar 1,778,956 lekë, si rrjedhojë e këtij veprimi renta minerare është llogaritur dhe deklaruar me pak për shumën prej **9,594,001 lekë**, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 66-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i kryer në dosjen e subjektit privat me leje nr. 1052 “P...” në zonën e shfrytëzimit Novaj Skrapar, Kruje, me objekt “Prodhim gurë gëlqerore”, konstatohet se subjekti për vitin 2016 ka realizuar të ardhura nga eksporti në shumën prej 29,506,352 lekë, (me çmim mestar 20,295 lekë/m³, fakt që tregon se subjekti prodhon gurë pllakor të mermerizuar), renta për këtë sasi është deklaruar dhe llogaritur në vlerën prej 400,694 lekë ose me tarifën 228 lekë/m³ që përkon me rentën “pllaka guri”. Sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur ligjit nr. 7995, datë 20.08.2008 renta duhet llogaritur me tarifën prej 4,550 lekë/m³. Nga të dhënat e më sipërme për sasinë prej 1,541 m³ pllake të mermerizuar renta duhet të ishte llogaritur në shumën prej 7,011,550 lekë dhe jo 400,694 lekë. Si rrjedhojë e këtij veprimi të ardhurat nga renta për buxhetin e shtetit janë llogaritur dhe deklaruar më pak për shumën prej **6,610,856 lekë**, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 67-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Rekomandimi (për pikën 7 dhe 8):

Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave dhe marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9689, datë 06.11.2015, Drejtoria Minerare nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të rakordojë të ardhurat nga prodhimi dhe shitja e mineralit dhe mënyrën e llogaritjes së rentës së deklaruar nga subjektet “Sh...” dhe “P...” për evidentimin e diferencave të mundshme në llogaritjen e rentës dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit të cilat nga auditimi janë llogaritur në vlerën rreth **16,204,000 lekë**.

D. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE:

Nisur nga shkeljet e konstatuara në këtë auditim si dhe nga auditimet e mëparshme ku janë lënë disa herë rekomandime të përsëritura, për zbatimin e të cilat është bërë shumë pak, KLSH insiston dhe do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do vlerësojë marrjen e masave, që do të marrë AKBN dhe MIE për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të monitorimit, mbikëqyrjes dhe shfrytëzimit sa më mirë të burimeve natyrore, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim dhe në dobi të popullit shqiptar.

E. REZERVA NË ZBATIMIN E PROGRAMIT TË AUDITIMIT

Për shkak të ngarkesës së madhe të auditimeve që KLSH ka pasur gjatë periudhës korrik-dhjetor 2018 dhe angazhimit njëkohësisht në disa objekte të tjera të audituesve që ishin planifikuar për kryerjen e këtij auditimi, pika 4 “Prokurimet e fondeve publike” dhe pika 5 “Shfrytëzimi i burimeve hidrokarbure” e këtij Programi Auditimi, nuk janë audituar dhe nuk janë përfshirë në këtë raport auditimi.

Këto drejtime auditimi janë planifikuar për tu audituar me një program ri auditimi në fillim të vitit 2019.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

